



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

www.idp.al

2022

RAPORTI VJETOR

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

PËRMBAJTJA

SHKURTIME	4
HYRJE	6
MESAZHI I KOMISIONERIT	7
1. E DREJTA PËR INFORMIM	9
1.1 MONITORIMI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE	10
1.2 INDEKSET E TRANSPARENCËS	12
1.2.1 Indeksi i Transparencës Proaktive të Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë.....	12
1.2.2 Indeksi i Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore	13
1.3 TRAJTIMI I ANKESAVE	13
1.4 INSTRUMENTET ELEKTRONIKE	16
1.4.1 Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit në portalin pyetshtetin.al	16
1.4.2 Sistemi AMS në portalin e-Albania.....	17
1.5 KONFERENCA NDËRKOMBËTARE E KOMISIONERËVE TË INFORMIMIT	17
2. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE	18
2.1 MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA.....	19
2.1.1 Trajtimi i ankesave.....	19
2.1.2 Hetimet administrative.....	19
2.1.3 Hetimet administrative në zbatim të Rezolutës së Kuvendit.....	20
2.1.4 Hetime pranë kontrolluesve të tjerë.....	23
2.2 VENDIMARRJA	24
2.2.1 Urdhra dhe Rekomandime.....	24
2.2.2 Vendime.....	25
2.3 REGJISTRI I NJOFTIMEVE	25
2.4 TRANSFERIMI NDËRKOMBËTAR.....	26
3.VEPRIMTARIA JURIDIKE, PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE	27
3.2 MIRATIMI I AKTEVE LIGJORE	27
3.2.1 Ratifikimi i Konventës 108+ të KiE.....	27
3.2.2 Ratifikimi i Konventës 205 të KiE	27
3.2.3 Miratimi i ligjit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.....	28
3.3 PROJEKTLIGJET PËR FUSHAT E PËRGJEGJËSISË.....	28
3.4 DHËNIE MENDIMI PËR PROJEKTAKTE.....	29
3.5 PROCESE GJYQËSORE	30
4. DOKUMENTE STRATEGJIKE	31
4.1 STRATEGJIA INSTITUCIONALE 2022-2025	31
4.2 PLANI I INTEGRITETIT 2022-2025	31
4.3 STRATEGJI NDËRSEKTORIALE	32

5. VEPRIMTARIA E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR.....	34
5.1 BASHKËPUNIMI ME AUTORITETIN HOMOLOG TË REPUBLIKËS KOSOVËS...	34
5.2 BASHKËPUNIMI ME AUTORITETIN HOMOLOG TË MALTËS	34
5.3 BASHKËPUNIMI ME QEVERINË E MBRETËRISË SË BASHKUAR	35
5.4 PJESËMARRJA NË FORUME DHE RRJETE NDËRKOMBËTARE	36
5.4.1 Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit.....	36
5.4.2 Asambleja Globale e Privatësisë.....	37
5.4.3 Pjesëmarrja në forume të tjera.....	38
6. NDËRGJEGJËSIMI DHE BASHKËPUNIMI ME GRUPET E INTERESIT.....	39
6.1 DITËT NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE	39
6.2 AKTIVITETE ME ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE.....	39
6.3 AKTIVITETE TË TJERA TË ZYRËS SË KOMISIONERIT	40
7. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCIARE.....	43
7.1 STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE	43
7.2 MENAXHIMI I BUXHETIT	44
7.3 ARKËTIME NGA SANKSIONET	45
8. PROCESI I INTEGRIMIT EVROPIAN.....	46
9. NIVELI I ZBATIMIT TË REZOLUTËS SË KUVENDIT.....	48
10. VIZIONI	49
ANEKSI 1 - STRUKTURA DHE ORGANIGRAMA.....	50
ANEKS 2 - REKOMANDIMET E ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR VITIN 2022 PËR INSTITUCIONET PUBLIKE DHE NIVELI I ZBATIMIT TË TYRE	53
ANEKS 3 - MONITORIMI I FLETOREVE ZYRTARE.....	76

SHKURTIME

TERMINOLOGJIA

AIP	Agjencia për Informim dhe Privatësi të Kosovës
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AP	Autoritete Publike
AMS	Sistemi i Menaxhimit të Aplikimit (Application Management System)
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
Akti Normativ nr. 12/2022	Akt normativ nr. 12, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar”
BE	Bashkimi Evropian (European Union)
Direktiva e Policisë	Direktiva (BE) 2016/680 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 prillit 2016 “Për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DPSHTRR	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
GDPR	Rregullore (BE) nr. 2016/679 “Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave” (General Data Protection Regulation)
GPA	Asambleja Globale e Privatësisë – Global Privacy Assembly
ICIC	Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit (International Conference of Information Commissioner)
KiE	Këshilli i Evropës (Council of Europe)
Ligji për të drejtën e informimit (LDI)	Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”
Ligji për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik	Ligji nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”
Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale	Ligji nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar
Ligji nr. 49/2022	Ligji nr. 49/2022, datë 12.05.2022, “Për ratifikimin e Protokollit ndryshues të Konventës “Për mbrojtjen e individëve, në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale (Konventa 108+)””

Ligji nr. 45/2022	Ligji nr. 45/2022, datë 28.04.2022 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumenta zyrtare (Konventa 205)”
NjVV	Njësi të Vetëqeverisjes Vendore
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PT	Programi i Transparencës, tërësia e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij nga autoriteti publik, sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 7 të ligjit për të drejtën e informimit
REKPD	Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit
RKP	Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve
Rezoluta e Kuvendit	Rezolutë për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2022, miratuar datë 28.04.2021
SMSI	Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
Urdhër nr. 14/2015	Urdhri nr. 14, datë 22.01.2015 “Për miratimin e Programit model të Transparencës”
Urdhër nr. 211/2018	Urdhri nr. 211, datë 10.09.2018 “Programi model i Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”
Urdhër nr. 187/2020	Urdhër nr. 187, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”
Urdhër nr. 188/2020	Urdhër nr. 188, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të rishikuar”
Udhëzim nr. 47/2018	Udhëzim nr. 47, datë 14.09.2018 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”
Udhëzim nr. 48/2018	Udhëzim nr. 48, datë 14.09.2018 “Për certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”
VKM nr. 145/2018	Vendim i Këshillit të Ministrave nr.145/2018 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore “Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të drejtën e informimit””
Vendimi i Kuvendit nr. 84/2020	Vendimi i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 84/2020 “Për disa shtesa e ndryshime të Vendimit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale””
Zyra e Komisionerit	Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

HYRJJE

Mbrojtja e të dhënave personale është e drejtë themelore, e sanksionuar në nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në nenin 8 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. E drejta për t'u informuar në lidhje me informacionin që prodhohet, apo mbahet nga autoritetet publike është pjesë thelbësore e së drejtës themelore të lirisë së shprehjes, të njohur nga rezoluta 59 e OKB-së, nga neni 19 i Deklaratës Universale të së Drejtave të Njeriut, nga neni 10 i Konventës Evropiane të së Drejtave të Njeriut, nga neni 11 i Kartës së të Drejtave Themelore të BE dhe që sanksionohet po ashtu në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Aktiviteti i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, udhëhiqet nga misioni i saj, në thelb të së cilit janë vlerat dhe parimet thelbësore, të cilat shprehen në vizionin e saj.

VIZIONI YNË

Të promovojmë dhe mbështesim një shoqëri që mban si vlera thelbësore garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtës për informim, në funksion të transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies.

MISIONI YNË

Të mbikëqyrim zbatimin e kuadrit ligjor të mbrojtjes së të dhënave dhe të së drejtës për informim, të garantojmë ushtrim të efektshëm të së drejtave në epokën digjitale dhe të rrisim ndërgjegjësimin e autoriteteve publike dhe kontrolluesve të të dhënave në sektorin publik dhe atë privat, i cili sjell përmirësimin e mentalitetit dhe kulturës së shoqërisë në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

OBJEKTIVAT TANË:

- Garantimi i zbatimit të standardeve më të larta rregullatore për përforcimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe së drejtës për informim në epokën e digjitalizimit të shpejtë.
- Rritja e kapaciteteve institucionale në kuadër të përmirësimeve legislative, me vëmendje të veçantë në zhvillimet teknologjike.
- Rol aktiv në rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e të drejtave të qytetarëve, duke vënë theksin tek edukimi i të rinjve.
- Zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me partnerët tanë ndërkombëtarë, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës për zbatimin e legjislacionit të modernizuar në të dy fushat e përgjegjësisë.

MESAZHI I KOMISIONERIT

Viti që lamë pas u shënjua nga zhvillime me ndikim në privatësinë dhe të dhënat personale të qytetarëve shqiptarë. Digjitalizimi i shpejtë i shërbimeve publike dhe veprimtarisë së sektorit privat, mbart sfida të pashmangshme, të cilat shoqërojnë në çdo hap zhvillimin teknologjik.

Përballimi i këtyre sfidave kërkon modernizim të vazhdueshëm të kuadrit legjislativ, përmirësim të praktikave dhe përfundim të bashkëpunimit të të gjithë aktorëve të përfshirë, qoftë në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Në punën tonë gjatë këtij viti jemi udhëhequr nga katër parime kryesore:

- Paanësia
- Integriteti
- Transparenca
- Bashkëpunimi.

Në këtë kuptim, jemi përpjekur që ekspertizën, autoritetin dhe kompetencat tona t'i vendosim në shërbim të interesit publik, për të garantuar që institucionet publike të respektojnë në praktikë parimet e mbrojtjes së të dhënave dhe të së drejtës së informimit, të rrisim ndërgjegjësimin për këto të drejta dhe të përqendrojmë vëmendjen tonë në fushat dhe sektorët që paraqesin risqe më të rënda, e që kanë ndikimin më të madh tek të drejtat e qytetarëve.

Angazhimi ynë proaktiv pasqyrohet qartë në numrin e lartë të inspektimeve të kryera me iniciativën tonë, edhe pse numri i ankesave vijon të rritet në mënyrë të konsiderueshme. Në raport me vitet e mëparshme, synimi ynë gjatë këtij viti ka qenë që kompetencat tona sanksionuese të jenë po aq proporcionale, sa edhe korrigjuese, për përmbushjen e objektivit tonë kryesor të krijimit të një kulture trajtimi etik dhe të përgjegjshëm të të dhënave personale. Cilësia, rëndësia dhe shtrirja e aktiviteteve tona audituese dhe inspektuese, por edhe vendimmarrja në përfundim të tyre, janë po ashtu indikatorë domethënës të kësaj qasjeje të re ligjzbatuese dhe ndërgjegjësimi.

Me ratifikimin e Konventës 108+ të KiE-së dhe aspektet e tjera të modernizimit të kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale që janë ende në proces miratimi, ne vijojmë të kryejmë përgatitje të konsiderueshme për nisjen e zbatimit të tij. Nga përditësimi paraprak i kuadrit nënligjor, riorganizimi i strukturës institucionale, tek krijimi i rrjetit të Nëpunësve të Mbrojtjes së të Dhënave, apo përfundimi i shkëmbimeve me autoritetet homologe dhe platformat e bashkëpunimit në nivel BE-je, e më gjerë, çdo aktivitet është kryer pikërisht në perspektivën e legjislationit të modernizuar dhe plotësisht të përpunuar me atë të Bashkimit Evropian.

Edhe në fushën e së drejtës për informim, përmirësimet e ligjit për të drejtën e informimit që priten të miratohen, si dhe miratimi i ligjit *“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”* krahas ratifikimit të Konventës së KiE-së për *“Për aksesin në dokumenta zyrtare”*, janë shoqëruar me përgatitje nga ana jonë, në drejtim të hartimit të akteve nënligjore, forcimit të kapaciteteve profesionale të stafit, ndërgjegjësimit të autoriteteve publike dhe rritjes së bashkëpunimit me grupet e interesit.

Kemi luajtur rol aktiv gjithashtu edhe në bashkëpunimin me autoritetet dhe organizatat homologe ndërkombëtare të fushës së të drejtës së informimit, ku përveç anëtarësimit në disa grupe ndërkombëtare pune, do të organizojmë në Shqipëri edhe konferencën botërore të Komisionerëve të Informimit (ICIC) në vitin 2024.

Së fundmi, vlen të përmendet se aktiviteti ynë nuk është shkurajuar nga vështirësitë që hasim për shkak të kapaciteteve dhe burimeve shpesh jo të mjaftueshme, por përkundrazi, jemi përpjekur të kapërcejmë çdo pengesë me shtimin e angazhimit dhe me përmirësimin e zhvillimin e praktikave të punës sonë.

Megjithatë, reformimi i legjislacionit në të dy fushat e aktivitetit tonë, shtimi i kompetencave, zhvillimi i shpejtë teknologjik dhe roli që do të luajmë në vitet në vijim, kërkojnë mbështetje dhe fuqizim të vazhdueshëm e domethënës për Zyrën e Komisionerit.

1. E DREJTA PËR INFORMIM

E drejta për informim përbën një nga të drejtat themelore të njeriut dhe vepron si parakusht për një qeverisje të hapur, që garanton transparencë dhe llogaridhënie. Transparenca është element kyç në një shoqëri demokratike dhe shërben për t'i dhënë qytetarëve, shoqërisë civile dhe medias mjetet për të vlerësuar se si menaxhohet pushteti dhe burimet e shtetit.

E drejta për informim është njohur dhe afirmuar gjerësisht vetëm kohët e fundit, por origjina dhe koncepti i saj burojnë që nga shekulli i XVIII. Kjo e drejtë është garantuar për herë të parë në legjislacionin suedez në vitin 1766 dhe nga pikëpamja historike, vendet nordike konsiderohen si pararendësit e çështjeve që lidhen me transparencën dhe aksesin në informacion. Finlanda ka miratuar legjislacionin për të drejtën e informimit në vitin 1961, ndërsa në vitin 1990 ky legjislacion u miratua nga 13 vende të tjera. Aktualisht përllogariten rreth 120 vende që kanë njohur të drejtën e informimit.

“Informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik.

E drejta e aksesit në informacion sanksionohet në instrumentet ndërkombëtare, si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut. Në vendin tonë, ajo garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në vitin 1999, Shqipëria miratoi ligjin e parë nr. 8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Zyrës së Komisionerit iu ngarkua kompetenca e mbikëqyrjes dhe monitorimit të këtij ligji. Që prej fillimit të zbatimit të tij, ne kemi bashkëpunuar ngushtë me autoritetet publike, shoqërinë civile dhe grupet e ndryshme të interesit, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për zbatim sa më efikas të së drejtës për akses në informacion publik. Aktualisht, legjislacioni ynë për të drejtën e informimit përmban standardet më të larta ndërkombëtare dhe është renditur ndër legjislacionet më të mira në botë.

Aktualisht, jemi në vitin e tetë të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit dhe vërejmë zhvillime të konsiderueshme, si në spektrin e detyrimeve të autoriteteve publike për të qenë transparente, ashtu edhe në atë të ndërgjegjësimit të shoqërisë civile, gazetarëve, qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit.

Megjithatë, zbatimi në praktikë i ligjit përballet me sfida të ndryshme. Ne kemi punuar në mënyrë intensive për përmirësimin e ligjit, mbështetur edhe në kontributin e vlefshëm të shoqërisë civile, apo grupeve të interesit, të cilët kanë ndikuar në mënyrë aktive në rritjen e llogaridhënies së autoriteteve publike.

Me ndërgjegjësimin e autoriteteve publike në lidhje me detyrimin për publikimin e informacioneve pa kërkesë, ose ndryshe transparencës proaktive, është rritur sasia e informacionit publik në programet e transparencës që ato publikojnë në faqet e tyre zyrtare, gjë

që sjell lehtësi për publikun. Megjithatë, mbetet ende shumë punë për të bërë, si në aspektin e transparencës proaktive, ashtu dhe në përgjigjen në kohë të kërkesave për informacion.


Në funksion të përmirësimit të kuadrit ligjor për të drejtën e informimit, do të vijojmë të përforcojmë kapacitetet e stafit dhe të ndërgjegjësojmë institucionet për zbatimin efikas të këtij kuadri ligjor.

Vëmendje të veçantë do t'i kushtojmë edhe trajnimit të koordinatorëve për të drejtën e informimit, sidomos në çështjet e trajtimit të kërkesave për informacion, ku kërkohet ekuilibrim i interesit publik me kufizimin e aksesit në informacion. Komunikimi dhe shkëmbimet me grupet e interesit dhe qytetarët do të vijojnë të jenë në themel të aktivitetit tonë, ashtu si edhe trajnimet për njohjen e kuadrit të ri ligjor të së drejtës për informim. Në këtë kontekst, do të vijojmë të mbajmë të rinjtë në qendër të objektivave tanë, për t'i informuar mbi të drejtat e tyre dhe rëndësinë që ka pjesëmarrja aktive në vendimmarrje. Sa i përket zhvillimeve teknologjike, do të këmbëngulim të punojmë ngushtësisht me institucionet kompetente, për të garantuar sisteme të sigurta dhe të qëndrueshme, në funksion të transparencës proaktive, dhe për t'u ofruar qytetarëve akses më të shpejtë në informacion, pa qenë nevoja të paraqesin kërkesa pranë institucioneve publike.

1.1 MONITORIMI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE


Transparenca proaktive është detyrim për autoritetet publike, i cili përmbushet nëpërmjet krijimit/përditësimit të Programit të Transparencës dhe Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve (nenet 7 dhe 8 të ligjit nr. 119/2014).

Gjatë ushtrimit të funksioneve tona monitoruese, kemi konstatuar se gjatë vitit 2022 ka pasur përmirësim në drejtim të publikimit dhe përditësimit të këtyre instrumenteve nga autoritetet publike, sipas modeleve të miratuara me Urdhërat nr. 211/2018, nr. 187/2020 dhe nr. 188/2020 të Komisionerit. Treguesit e paraqitur në tabelën e mëposhtme flasin për një nivel prej 89% të autoriteteve publike që e kanë të publikuar PT-në, me një rritje prej 9%, sipas listës prej 374 AP të mbajtur nga Zyra e Komisionerit.




Të dhënat statistikore në tabelën e mëposhtme, tregojnë një kurbë rritëse për të tre komponentët, për periudhën 2020-2022. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka luajtur

zhvillimi i takimeve periodike me AP-të, me qëllim ndërgjegjësimin e tyre për përmirësimin e problematikave, bazuar në konstatimet e Indekseve të Transparencës 2021.



Jemi fokusuar gjithashtu në monitorimin *online* të PT-ve të organeve të prokurorisë, të cilat edhe pse e kishin të publikuar si ikonë këtë instrument, nuk e kishin përditësuar/pasuruar atë sipas rubrikave përkatëse, me pretendimin se ky i fundit është i njëjtë me atë të PT-së së Prokurorisë së Përgjithshme. Në përfundim të kësaj veprimtarie, Komisioneri doli me 28 rekomandime specifike për strukturat e të gjitha niveleve, në mënyrë që informacioni në rubrikat respektive të jetë i harmonizuar me modelet në fuqi, detyrime të cilat u përmbushën brenda afatit dhe janë në përditësim të vazhdueshëm.

REKOMANDIME PËR PROGRAMET E TRANSPARENCËS NDËR VITE



Po ashtu, realizuam 50 inspekte në 35 AP qendrore/varësie dhe 15 NJVV me shtrirje në të gjithë territorin e vendit, bazuar në mangësitë e konstatuara në Indeksin e Transparencës 2021. Pjesë e këtij procesi ishte edhe zhvillimi i 5 seancave dëgjimore. Nisur edhe nga bashkëveprimi me inspektorët e Zyrës së Komisionerit, në përfundim të procedurës, AP-të plotësuan detyrimet e transparencës proaktive: publikimin/përditësimin e PT-së dhe RKP-së dhe caktimin e koordinatorit. Institucioni ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me koordinatorë, specialistë të TIK-ut, apo dhe me persona përgjegjës, për identifikimin dhe publikimin e informacionit/dokumentacionit, si dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit.

Nisma më e re e Zyrës së Komisionerit është projekti “Ditët e Transparencës”, i realizuar në 6 qytete-qendër qarku: Lezhë, Berat, Elbasan, Kukës, Durrës dhe Dibër. Qëllimi kryesor i saj

është njohja e situatës dhe zbatimi i detyrimeve të parashikuara në legjislacionin për të drejtën e informimit. Nga ana tjetër, në fokus është ndërgjegjësimi me qëllim përfshirjen e sa më shumë aktorëve në këtë proces: qytetarë, organizata të shoqërisë civile dhe media, për të ushtruar presion pozitiv mbi AP-të, me synim forcimin e transparencës proaktive dhe mirëqeverisjen. Realizimi i këtyre aktiviteteve dha ndihmesë në:

- *Përmirësimin e transparencës proaktive nga ana e autoriteteve publike vendore;*
- *Rritjen e numrit të kërkesave për informacion/dokumentacionit publik të përmbushura;*
- *Përmirësimin e komunikimit e administratës publike vendore me qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile, për njohjen dhe ushtrimin e kësaj të drejte.*

Kjo nismë do të vijojë të zbatohet edhe me takime, në gjysmën tjetër të qarqeve të vendit gjatë vitit 2023. Rezultati i bashkëveprimit të Zyrës së Komisionerit me njësitë e vetëqeverisjes vendore pasqyrohet edhe në gjetjet e Raportit të Komisionit Evropian të vitit 2022 për Shqipërinë, ku vlerësohet përmirësimi i transparencës së bashkive, duke qenë se të gjitha NJVV-të kanë publikuar vendimet e këshillave të tyre.

1.2 INDEKSET E TRANSPARENCËS

Për të tretin vit radhazi, kemi hartuar Indekset e Transparencës për Institucionet Qendrore e të Varësisë dhe ato të Njërive e Vetëqeverisjes Vendore, me qëllim matjen e transparencës proaktive.

1.2.1 Indeksi i Transparencës Proaktive të Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë

U verifikua niveli i transparencës proaktive në 150 institucione qendrore, për institucione si: kryeministria/ministritë dhe AP-të e varësisë, institucionet e pavarura, sistemi gjyqësor, sistemi i prokurorisë, universitetet dhe shoqëritë me kapital publik. Monitorimi u realizua gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2022, ku metodologjia e përdorur i referohet 8 treguesve të mëposhtëm:

- *publikimi i programit të transparencës;*
- *publikimi i të dhënave të koordinitorit për të drejtën e informimit;*
- *publikimi i regjistrat të kërkesave dhe përgjigjeve i rishikuar për vitin 2022;*
- *publikimi i të dhënave të buxhetit për vitin financiar 2022;*
- *publikimi i raporteve të auditimit dhe monitorimi (p.sh. Raport i KLSH-së dhe/ose raporte auditit të brendshëm);*
- *publikimi i strukturës;*
- *publikimi i legjislacionit;*
- *publikimi i CV-së së titullarit.*


Në krahasim me monitorimin e kryer në vitin 2021, konstatohet se këto autoritete publike kanë një performancë më të mirë në publikimin e informacionit/dokumentacionit në PT, në faqet e tyre zyrtare në internet. Nga 150 institucione të monitoruara, 149 prej tyre e kanë të publikuar PT-në, ndërkohë, që të gjitha (100%) kanë caktuar koordinatorin për të drejtën e informimit. Megjithatë, ende mbetet një sfidë publikimi proaktiv i kategorive të tjera të informacionit.

1.2.2 Indeksi i Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Në monitorimin e kryer për këtë kategori, po në periudhën nëntor-dhjetor 2022, është përdorur sistemi i matjes së 9 treguesve kryesorë, të cilët janë renditur më poshtë:

- publikimi i programit të transparencës;
- publikimi i të dhënave të koordinatorit për të drejtën e informimit;
- publikimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve i rishikuar për vitin 2022;
- publikimi i të dhënave të PBA-së 2022-2024;
- publikimi i raporteve të auditimit dhe monitorimi (p.sh. Raport i KLSH-së, ose raporte audit të brendshëm);
- publikimi i informacionit mbi “Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik”;
- publikimi i strukturës;
- publikimi i legjislacionit;
- publikimi i CV-së së titullarit.

Në krahasim me monitorimet e mëparshme, konstatohet rritje e transparencës, edhe për shkak të faktit se është shtuar numri i kategorive të informacionit/dokumentacionit që është marrë në shqyrtim. Performanca pozitive në rritje, në veçanti për PT-në, RKP-në dhe caktimin e koordinatorit, shprehet në tabelën e mëposhtme.




Të dy këto raporte gjenden të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Komisionerit dhe mund të konsultohen në lidhjen: <https://www.idp.al/raporte-monitorimi-2022/>.

1.3 TRAJTIMI I ANKESAVE

Zyra e Komisionerit konstaton, se edhe gjatë 2022, ka qëndrueshmëri të numrit të ankesave krahasuar me vitin e kaluar. Në total, autoriteti administroi 1032 ankesa, si dhe vijoi me shqyrtimin administrativ të 49 procedurave të mbartura nga viti 2021 (gjithsej **1081 ankesa**).



Rezulton se pesha specifike e ankesave për mosdhënie të informacionit të administruara nga Zyra e Komisionerit, vijon të anojë nga NJVV-të në raport me AP-të e tjera, edhe pse kjo përqindje është më e ulët krahasuar me 2021. Në shifra nominale, për vitin 2022, ndaj NJVV-ve u depozituan 288 ankesa dhe ndaj AP-ve të tjera 744 ankesa.




Referuar të dhënave, për aq sa mund të indentifikohen, ankesat e paraqitura janë grupuar në katër kategori, sipas grafikut të mëposhtëm.




	2021	2022
Gazetarë	409	456
Qytetar	322	343
OSHC	231	196
Avokatë	30	37

Nga totali prej 1081 ankesash, për 643 prej tyre informacioni/dokumentacioni i kërkuar u është vënë në dispozicion ankuesve, gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ nga ana e Zyrës së Komisionerit. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit është shprehur me 51 vendime për 61 ankesa. Nga këto vendime, janë dhënë 35 vendime urdhërimi për dhënie informacioni, 9 vendime rrëzimi, 4 vendime mospranimi dhe 3 vendime me sanksion administrativ.

Ndërkaq, 217 ankesa kanë rezultuar jashtë objektit, çka përbën ende një numër të konsiderueshëm, të cilat rezultojnë për çështje me natyrë individuale, ose trajtohen nga ligje të tjera specifike. Për zvogëlimin e kësaj kategorie ankesash është i domosdoshëm një ndërgjegjësim i vazhdueshëm mbi dispozitat ligjore për të drejtën e informimit. Gjithashtu, rezultojnë 21 ankesa të refuzuara, bazuar në kufizimet e LDI-së, 76 ankesa janë paraqitur jashtë afatit, 15 ishin të paplota, si dhe 48 të tjera janë mbartur për shqyrtim në vitin 2023. Për një transparencë më të lartë për publikun, Zyra e Komisionerit publikon në portalin pyetshtetin.al listën e ankesave të administruara, e cila mund të konsultohet lehtësisht nga qytetarët dhe grupet e interesit.



Si pjesë e procesit të shqyrtimit administrativ për ankesat e depozituara, u zhvilluan 32 inspektive pranë autoriteteve publike dhe 72 seanca dëgjimore me praninë e palëve.



Qytetarët apo grupet e interesit e përqendruan kërkimin e informacionit/dokumentacionit për fondet/procesin e rindërtimit, sistemin shëndetësor/pandeminë, për çështje në arbitrazhin ndërkombëtar, koncensionet, prokurimet, vendime të gjyqësorit, të dhëna statistikore mbi veprimtarinë e autoriteteve publike, etj. Nga shqyrtimi i ankesave Zyra e Komisionerit ka konstatuar disa problematika, ndër më kryesoret prej të cilave përmendim:

- i. vështirësi të hasura në trajtimin e kërkesave për informim, si rezultat i sulmit kibernetik në faqet zyrtare të AP-ve, që për rrjedhojë ka sjellë mosrespektimin e afateve. Zyra e Komisionerit duke mirëkuptuar situatën e krijuar, nuk ka përjashtuar autoritetet publike nga detyrimi i tyre në lidhje me transparencën.
- ii. Vijon paqartësia nga ana e AP-ve, në lidhje me parimin e konfidencialitetit në kontratat publike dhe sekretin tregtar trajtuar jo në përputhje me parashikimet e nenit 17 të LDI-së. Në kontratat publike shpesh parashikohen dispozita konfidencialiteti për informacionin/dokumentacionin që lidhet me to dhe në rast të mos zbatimit të tyre, parashikohen sanksione ndaj AP-ve. Për të shmangur këtë problematikë, është e nevojshme që në klauzolat e konfidencialitetit të qartësohen se mbi cilën pjesë të informacionit shtrihen ato, duke pasur parasysh që nuk mund të mbizotërojnë mbi parashikimet e ligjit për të drejtën për informim, përveçse kur parashikohet në ligjin specifik.
- iii. Janë konstatuar raste të delegimit të kërkesës për informacion nga njëri AP tek tjetri, edhe pse disponohet informacioni i kërkuar.
- iv. Kërkesit vijnë të përdorin dispozitat e LDI-së përtej objektit dhe qëllimit të tij për çështje/praktika administrative me karakter individual, si: akses në të dhënat personale, dokumentacioni lidhur me lejet e ndërtimit, pasojat e tërmeteve të vitit 2019, pronësia, procedurat e rekrutimit, etj.
- v. Konstatohet shtim i numrit të kërkesave nga avokatët për akses në dokumentacionin e njehësuar, i cili shërben si provë në procese gjyqësore, duke anashkaluar në këtë mënyrë Ligjin për Avokatinë, apo Kodin e Procedurave Administrative.
- vi. Vijnë kërkesat për pyetje, intervista, apo prononcime në media drejtuar autoriteteve publike/titullarëve, në tejkalim të qëllimit të LDI-së.
- vii. Ende konstatohet ndryshim i shpeshtë i koordinatorit, caktim i tij apo i saj në nivel ekzekutiv, apo të ulët drejtues, si dhe kufizim akses në strukturat e tjera të AP-së. Për shkak të rolit dhe përgjegjësisë që koordinatori ka në trajtimin e kërkesave për informacion, Zyra e Komisionerit në mënyrë të vazhdueshme udhëzon AP-të të marrin masa për forcimin e pozitës së tij.

Për sa më sipër, një pjesë e këtyre problematikave janë adresuar për zgjidhje me propozimet për përmirësimin e LDI-së. Megjithatë, veprimtaria jonë do të vazhdojë të fokusohet në procesin trajnues dhe ndërgjegjëses me të gjithë aktorët/faktorët e procesit të transparencës.


1.4 INSTRUMENTET ELEKTRONIKE

1.4.1 Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit në portalin pyetshtetin.al

Portali pyetshtetin.al është një instrument elektronik, i cili përbën një mënyrë të shpejtë dhe të thjeshtë për marrjen e informacionit me karakter publik nga qytetarët. Gjatë vitit 2022 është punuar në drejtim të përmirësimeve teknike dhe përditësimit/saktësimit të të dhënave për të gjitha autoritetet publike, si: emërtesat, kontaktet e koordinatorëve, lidhjen (link) me faqen zyrtare dhe veçanërisht, me PT-në, etj. I krijuar që në vitin 2018, Zyra e Komisionerit ka synuar që ky portal të funksionojë si një platformë e qendëruar transparence proaktive.

Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPD), i integruar në këtë instrument sipas VKM-së nr. 145/2018, mundëson ushtrimin e së drejtës për informim me kërkesë dhe eventualisht të ankesës pranë Zyrës së Komisionerit. Kjo mënyrë

siguron përfshirjen e drejtpërdrejtë të koordinatorit dhe garanton gjurmueshmërinë e procesit, duke mos lënë hapësira për abuzim dhe/ose shmangie të përmbushjes së detyrimeve ligjore. Në vitin 2022 u realizua dyfishimi i instalimit të REKPDI, duke e çuar në 195 numrin e AP-ve, nga 95 që kjo shifër ishte në fund të 2021. Janë zhvilluar paralelisht trajnime të rregullta me koordinatorët për mënyrën e përdorimit të tij. Nëpërmjet tij janë dërguar nga qytetarët dhe grupet e interesit 324 kërkesa për informacion, ndërsa janë administruar 101 ankesa nga Zyra e Komisionerit.



1.4.2 Sistemi AMS në portalin e-Albania

Në përmbushje të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2022, si dhe bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 119/2014, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me AKSHI-n ka vijuar punën për instalimin e Sistemit të Menaxhimit të Aplikimit. Si një mënyrë alternative, AMS-ja u mundëson qytetarëve kërkesën për informacion dhe të drejtën e ankesës pranë Zyrës së Komisionerit. Ky sistem është bërë funksional edhe për 102 AP të tjera, duke e çuar numrin e përgjithshëm të institucioneve, në fund të vitit 2022, në 163 të tilla. Koordinatorët janë trajnuar dhe njohur me modalitetet teknike të përdorimit të këtij sistemi, i cili megjithatë, është përdorur në mënyrë shumë të kufizuar nga qytetarët.

1.5 KONFERENCA NDËRKOMBËTARE E KOMISIONERËVE TË INFORMIMIT

Me votim unanim të anëtarësisë, gjatë punimeve të Sesionit të Mbyllur të edicionit të 13-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC), u vendos që ky aktivitet vjetor të mbahet në Shqipëri, në pranverën e vitit 2024. Çaktimi i Zyrës së Komisionerit si autoriteti organizator i Konferencës, vjen si rezultat i rolit aktiv që kemi luajtur në bashkëpunimin ndërkombëtar edhe në fushën e së drejtës për informim. Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit është forumi më i madh dhe më i rëndësishëm në nivel botëror në fushën e së drejtës për informim. Me organizimin e saj në Shqipëri, synojmë të japim kontribut jo vetëm për promovimin e vendit tonë, por edhe të ndërgjegjësojmë autoritetet publike, në lidhje me detyrimet e tyre për respektim të së drejtës themelore për informim dhe për transparencë.

2. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

E drejta për mbrojtje të të dhënave personale buron nga e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës, në themel të së cilës është dinjiteti njerëzor. Ajo parashikohet nga neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), dhe përbën një të drejtë themelore të individit. Sot, mbrojtja e të dhënave personale përfaqëson një aspekt kyç, si për aktivitetin e shoqërive tregtare, ashtu edhe për individët, sidomos duke pasur parasysh zhvillimet teknologjike dhe digjitalizimin e shërbimeve. Këto të fundit janë pjesë e një procesi të pakthyeshëm, që përfshin rritje masive të përdorimit të internetit dhe platformave online, ku rrjedhimisht mbrojtja e të dhënave personale merr rol vendimtar dhe qendror.

Edhe në legjislacionin shqiptar mbrojtja e jetës private dhe të dhënave personale është një nga liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, e sanksionuar në nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nga ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* të ndryshuar, së bashku me aktet nënligjore të zbatim të tij. Ky kuadër normativ garanton zbatimin e kësaj të drejte dhe njëkohësisht rregullon përpunimin e të dhënave personale, si në sferën publike, ashtu edhe në atë private.

“E dhëna personale” është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

E shprehur më thjeshtë, ligji për mbrojtjen e të dhënave përcakton mënyrën e drejtë dhe legjitime të përdorimit të të dhënave personale të të gjithë individëve. Ai është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga të gjitha institucionet publike dhe ndërmarrjet private, të cilat duhet të jenë para së gjithash të interesuara të veprojnë në përputhje me të dhe të garantojnë përpunim të sigurt të të dhënave personale, në mënyrë që të fitojnë besimin e publikut rreth shërbimeve që ato ofrojnë.

Çdo organizatë, ndërmarrje, apo institucion që mbledh, përdor, shkëmben apo mban të dhëna personale duhet të ketë një strategji për mbrojtjen e tyre, e cila, nëse është e ndërtuar në mënyrën e duhur dhe e mirëmenduar, i ndihmon ato të parandalojnë humbjen, vjedhjen, apo cenimin e të dhënave, si dhe të zvogëlojnë dëmet e pasojat që shkaktojnë shkeljet apo incidentet ndaj të dhënave personale.

Teksa digjitalizimi vijon të shtrihet në çdo sektor, apo aspekt të veprimtarive të sektorit publik e privat, ku shërbimet për qytetarët dhe biznesin ofrohen në një pjesë të madhe vetëm në rrugë elektronike, jo gjithnjë këto zgjidhje e shërbime digjitale shoqërohen edhe me ndërjegjësim, për sa i takon detyrimeve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Platformat dhe teknologjitë moderne që përdoren për të ofruar zgjidhje digjitale për qytetarët dhe bizneset, paraqesin sfida tepër kritike në fushën e sigurisë së informacionit. Në këtë kuptim, përfitimet e shumta që ato ofrojnë, shoqërohen me risqe të shtuara për mbrojtjen e të dhënave, ose mund të ndërhyjnë rëndë në sferën private të individëve. Për rrjedhojë, ato duhen identifikuar dhe menaxhuar në mënyrë proaktive dhe etike.

Sikurse të dhënat personale janë thelbësore për novacionin dhe zhvillimin teknologjik, edhe mbrojtja e tyre meriton të njëjtin vlerësim. Kësisoj, lehtësohet qarkullimi i tyre, rritet besimi i publikut dhe përfitimet për të gjithë aktorët e përfshirë.


2.1 MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA

2.1.1 Trajtimi i ankesave

Për vitin 2022, kemi administruar 370 ankesa nga qytetarët, nga shqyrtimi i të cilave, objekti i tyre kategorizohet si më poshtë:

- mosrespektimi i së drejtës për akses, si një e drejtë e rëndësishme e subjektit të të dhënave, që lejon këtë të fundit të marrë informacion nga kontrolluesi lidhur me përpunimin e të dhënave të tij;
- publikimi i të dhënave personale në media;
- përhapja e paligjshme e të dhënave personale nga institucionet publike;
- ushtrimi i të drejtës së subjekteve për korrigjim/fshirje të të dhënave personale;
- marketingu i drejtpërdrejtë në lidhje me komunikimet e pakërkuara.

Ushtrimi në rritje i kësaj të drejte është rezultat si i ndërgjegjësimit të qytetarëve, por edhe i mosnjohjes sa dhe si duhet, apo moszbatimit të kuadrit ligjor nga kontrolluesit/përpunuesit. Tendenca në rritje e numrit të ankesave gjatë viteve të fundit, është tregues për rëndësinë që po i kushtojnë individët kontrollit dhe mbrojtjes së të dhënave të tyre personale.




2.1.2 Hetimet administrative

Gjatë vitit 2022, kemi ushtruar hetime administrative në kontrollues publikë dhe privatë, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së tyre përpunuese në raport me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.



Në total, u zhvilluan 48 procedura hetimi administrativ, prej të cilave 10 mbi bazë ankese individuale dhe 38 me iniciativën e Zyrës së Komisionerit (*ex-officio*). Sa i përket sferave të veprimtarisë, 10 procese hetimi administrativ u ndërmorën në kontrollues publikë dhe 38 në kontrollues privatë.



2.1.3 Hetimet administrative në zbatim të Rezolutës së Kuvendit

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit për vitin 2022, jemi angazhuar në zhvillimin e proceseve të hetimit administrativ në tre drejtime kryesore:

- për përhapjen e paligjshme të të dhënave personale;
- për masat tekniko-organizative për përpunimin e sigurt të të dhënave personale (SMSI);
- për zbatimin e rekomandimeve të lëna më herët.

Kjo veprimtari është shtrirë në kontrollues që për shkak të funksioneve, apo shërbimeve që ofrojnë, përpunojnë kategori dhe sasi të mëdha të dhënash personale të qytetarëve. Nisur nga ky fakt, procedurat e hetimeve administrative kanë rezultuar komplekse dhe voluminoze, sidomos për trajtimin e çështjeve në raport e në harmoni me akte të tjera ligjore dhe/ose nënligjore.

▪ Hetime administrative për përhapjen e paligjshme të të dhënave personale

Zyra e Komisionerit ka përmbyllur hetimet administrative që u zhvilluan pranë kontrolluesve për publikimin e databazës me të dhënat e pagave të qytetarëve dhe databazës me të dhënat e targave automjeteve, në dhjetor të vitit 2021. Në lidhje me to, zhvilluam hetime administrative pranë kontrolluesve: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit. Gjithashtu, hetime administrative u ndërmorën edhe ndaj kontrolluesve privatë që ofrojnë shërbime inxhinierike të pajisjeve dhe sistemeve për llogari të AKSHI-it, për funksionimin e bazave të të dhënave të DPT-së dhe DPSHTRR-së.

Gjatë këtyre hetimeve të zhvilluara pranë institucioneve DPT dhe DPSHTRR u konstatuan këto problematika:

- ✓ kontrolluesit nuk respektojnë parimet e mjaftueshmërisë dhe kohëzgjatjes së ruajtjes së të dhënave personale;

- ✓ kontrolluesit nuk përcaktojnë në mënyrë të qartë databazat në të cilat legjitimohet të kenë akses dhe kategoritë e të dhënave që duhet të aksesojnë në secilën databazë, pasi janë konstatuar raste në tejkalim të parimit të mjaftueshmërisë së të dhënave;
- ✓ subjektet e të dhënave nuk informohen qartësisht mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin/at që do t'u përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë;
- ✓ në kontratat me palët e treta është konstatuar se kontrolluesit nuk parashikojnë detyrimet në përputhje me normat përkatëse ligjore;
- ✓ kontrolluesit nuk respektojnë detyrimin për njoftim dhe përditësimin e tij, sa herë që përpunohen kategori apo sasi të reja të dhënash personale;
- ✓ kontrolluesit nuk kanë marrë masa të përshtatshme për formalizimin dhe dokumentimin e politikave dhe procedurave të mënyrës së dhënies së të drejtës së aksesit;
- ✓ mungojnë masat tekniko-organizative për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale;
- ✓ mungojnë masat konkrete të sigurisë në sistemet elektronike të përdorura nga kontrolluesit, me qëllim për të garantuar sigurinë dhe pacenueshmërinë e sistemeve të infrastrukturave kritike të përdorura nga këto institucione shtetërore;
- ✓ mungesë e gjurmueshmërisë së veprimeve përpunuese dhe verifikimi i vazhdueshëm i tyre në sistemet elektronike, si një nga masat kryesore për garantimin e sigurisë së të dhënave personale dhe konfidencialitetit të tyre;
- ✓ mungojnë elementë të infrastrukturës së nevojshme për ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e SMSI, sipas legjislacionit në fuqi;
- ✓ ka mungesë të angazhimit të kontrolluesve për sa i përket domosdoshmërisë së trajnimit të vazhdueshëm të punonjësve që kanë akses në të dhënat personale dhe mbikëqyrin proceset përpunuese. Zyra e Komisionerit vlerëson se duhet të konsolidohen praktikat e punës të personit të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale në raport me legjislacionin specifik që rregullon veprimtarinë e kontrolluesve;
- ✓ ka mungesë angazhimi për të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve dhe detyrave të lëna në inspektimet e mëparshme nga institucioni.

Në përfundim të hetimeve administrative, Komisioneri ka dalë me Vendimet nr. 51 dhe 52, datë 24.11.2022, respektivisht për kontrolluesit DPSHTRR dhe DPT. Për kontrolluesit dhe/ose përpunuesit e tjerë, procesi i hetimit administrativ vijon ende, për shkak të kompleksitetit të këtyre inspektimeve. Njëkohësisht, zgjatja e procedurës administrative ka ardhur edhe si pasojë e gjëndjes së krijuar pas sulmeve kibernetike, investimeve paralele të nisura nga organet ligjzbatuese, apo hetimeve të tjera të kryera nga autoritete kombëtare/ndërkombëtare të zhvilluara në këtë kuadër.

▪ **Hetime administrative me fokus masat tekniko-organizative për përpunimin e sigurt të të dhënave personale**

Vëmendja e Zyrës së Komisionerit, në kontekstin e ngjarjeve të rënda të 2-3 viteve të fundit me përhapjen masive të të dhënave, është fokusuar në zhvillimin e hetimeve administrative mbi domosdoshmërinë e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI).

- Në sektorin e sigurimeve u zhvilluan 4 hetime administrative *ex-officio* në kontrollues privatë, për mbikëqyrjen e zbatimit të detyrimeve ligjore për masat tekniko-organizative për përpunimin e të dhënave personale, veçanërisht për SMSI-të. Njëkohësisht, janë

verifikuar edhe zbatueshmëria e rekomandimeve të dhëna më herët nga institucioni. Si përfundim, gjatë vitit 2022 Komisioneri ka dalë me 1 Vendim dhe për kontrolluesit e tjerë vendimmarrja është përmbyllur në vitin pasardhës me 1 Vendim dhe 2 Rekomandime.

- Në sektorin financiar jo bankar u zhvilluan 4 hetime administrative *ex-officio* në kontrollues privatë. Objekt i këtyre proceseve ishte, po ashtu, verifikimi i masave tekniko-organizative për përpunimin e të dhënave personale dhe veçanërisht, SMSI-të. Në përfundim, Komisioneri ka dalë me 4 Rekomandime.
- Në sektorin e marketingut të drejtpërdrejtë u zhvilluan 7 inspektime në kontrollues privatë, iniciuar nga ankesa individuale, me objekt mesazhet reklamuese të padëshiruara/të pakërkuara, pa dhënë pëlqimin për përdorimin e të dhënave personale (numrin e telefonit). Në përfundim, Zyra e Komisionerit ka dalë me 6 Vendime dhe 1 Rekomandim. Vlen të theksohet se kjo është një problematikë e përsëritur, e cila merr zgjidhje me miratimin e projektligjit “Për krijimin e Regjistrit të komunikimeve tregtare të pakërkuara”.

Gjatë hetimeve administrative në këta tre sektorë u konstatuan këto problematika:

- ✓ *kryerja e përpunimit të të dhënave personale në mënyrë të përsëritur jo në përputhje me parimet dhe kriteret rregullatore;*
- ✓ *kontrolluesit nuk informojnë qartësisht subjektet e të dhënave mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, personin/at që do t'i përpunojë ato dhe masat e sigurisë;*
- ✓ *kontrolluesit nuk respektojnë detyrimin për të njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit sa herë që përpunohen kategori apo sasi të ndryshme të të dhënave, me qëllim informimin e subjektit të të dhënave për çdo përpunim të ri të tyre;*
- ✓ *mungesë e një “Rregullore specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”;*
- ✓ *mungesë angazhimi në drejtim të trajnimit të punonjësit/sve që kanë akses në të dhënat personale dhe mbikëqyrin proceset përpunuese dhe në drejtim të konsolidimit të praktikave dhe legjislacionit specifik që rregullon veprimtarinë e tyre;*
- ✓ *mungesë të rregullave të qarta për garantimin e mbrojtjes, përpunimit, ruajtjes dhe sigurisë së të dhënave personale, në mënyrë që të përcaktojnë procedurat organizative dhe teknike në lidhje me masat për mbrojtjen e të dhënave personale;*
- ✓ *mungesë e çdo elementi të infrastrukturës së nevojshme për ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas akteve nënligjore në fuqi;*
- ✓ *publikimi i fotove/videove të nxënësve në rrjetet sociale të marra gjatë mësimi apo aktiviteteve kulturore e sportive, kryhet në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore për përpunimin e tyre;*
- ✓ *për sektorin e tregtimit të drejtpërdrejtë konstatohet se siguri i të dhënave personale është bërë në rrugë jo ligjore dhe nuk respektohet kriteri i dhënies së pëlqimit sipas dispozitave rregullatore.*

Një strategji e mbrojtjes së të dhënave është e domosdoshme për çdo kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale të qytetarëve dhe ndihmon në parandalimin e humbjes, vjedhjes apo cenimit të tyre. Teknologjia dhe mbrojtja e të dhënave personale sot ecin paralelisht me njëra-tjetrën. Ofrimi i shërbimeve cilësore, të sigurta dhe transparente nënkupton edhe përdorimin e burimeve në drejtim të masave për minimizimin, apo eliminimin e rreziqeve

në këtë drejtim. Praktika e mirë në mbrojtjen e të dhënave personale garanton besimin e publikut.

■ **Monitorimi i zbatimit të masave të lëna në rekomandimet e mëparshme**

Kemi ushtruar hetime administrative në kuadër të verifikimeve të zbatimit të 101 rekomandimeve të dhëna në periudhën 2019-2021, si në sferën publike ashtu edhe në atë private. Në tërësi konstatohet se një numër i konsiderueshëm i kontrolluesve kanë përmbushur detyrimet ligjore, plotësisht dhe në afatet e përcaktuara, çka përbën tregues të ndërgjegjësimit në rritje për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve. Nga ana tjetër, 7 kontrolluesve u është vendosur sanksion administrativ, për mospërmbushje të detyrimeve të lëna në Rekomandimet e mëparshme, të tilla si; marrja e masave për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, garantimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave, marrja e masave të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave, etj.

2.1.4 Hetime pranë kontrolluesve të tjerë

Zyra e Komisionerit e konsideron shumë të rëndësishme zbatimin rigoroz të parimit të mjaftueshmërisë në mbledhjen e të dhënave personale. Me këtë fokus, zhvilluam hetime administrative pranë kontrolluesve: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Objekti i procedurave të hetimit administrativ ishte verifikimi i procesit të përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesit për aksesin që ata kanë në baza të dhënash ndryshme shtetërore. Ndër problematikat e konstatuara përmendim:

- ✓ *ka ende një nivel të pamjaftueshëm njohurish dhe mungesë të qartë angazhimi për të përmbushur dhe respektuar dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në raport me ushtrimin e detyrave të tyre funksionale;*
- ✓ *nuk janë parashikuar afate konkrete të ruajtjes së të dhënave personale, si për ato të ruajtura në arkivën fizike, ashtu edhe në sistemin elektronik;*
- ✓ *nuk identifikohen qartë databazat në të cilat legjitimohen të kenë akses dhe kategoritë e të dhënave që duhet të aksesojnë në secilën prej tyre, si dhe në disa raste, është verifikuar akses në tejkalim të parimit të mjaftueshmërisë së të dhënave;*
- ✓ *nuk identifikohen në mënyrë konkrete të gjitha proceset përpunuese, me qëllim që të parashikohen rregulla të qarta në dokumente të mirëfillta rregullatore;*
- ✓ *nuk informohen qartë dhe saktë qytetarët për proceset përpunuese të të dhënave sipas modaliteteve ligjore;*
- ✓ *nuk dokumentohet me aktet përkatëse delegimi i shërbimeve të ndryshme nga kontrolluesi te përpunuesi, kur në thelb të tyre ka edhe përpunim të të dhënave personale;*
- ✓ *rezulton se në rregulloret e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale ka përmbajtje të kufizuar dhe nuk reflektohen saktë detyrimet ligjore për kategori specifike, apo sensitive të dhënash personale;*
- ✓ *nuk dokumentohet marrja e masave të përshtatshme tekniko-organizative të aksesit në sistemet elektronike, me qëllim parandalimin nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, apo përhapje nga persona të paautorizuar të të dhënave, veçanërisht, kur përpunimi kryhet nëpërmjet këtyre sistemeve. Në lidhje me këtë aspekt, vërehet mungesë koordinimi dhe bashkëpunimi midis institucioneve, ku palët vijnë të shmangin përgjegjësitë te njëri-tjetri;*

- ✓ *mungojnë elementë të infrastrukturës së nevojshme për ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e SMSI-së, sipas parashikimeve të akteve përkatëse nënligjore;*
- ✓ *ka mungesë angazhimi për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve që kanë akses në të dhënat personale dhe mbikëqyrin proceset përpunuese;*
- ✓ *duhet të caktohet personi i kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të konsolidohen praktikat në këtë drejtim.*

Në përfundim, Komisioneri ka dalë me 2 Rekomandime dhe 2 Vendime dhe një procedurë është pezulluar për shkak të situatës së shkaktuar nga sulmet kibernetike.

2.2 VENDIMMARRJA

2.2.1 Urdhra dhe Rekomandime

Në zbatim të detyrimeve ligjore, për qartësimin e rrethanave dhe fakteve në lidhje me të gjitha proceset administrative të kryera, u zhvilluan 41 seanca dëgjimore me pjesëmarrjen e palëve.

Vendimmarrja në këtë kuadër ka konsistuar si më poshtë:

- 1 Urdhër për fshirjen e të dhënave personale
- 8 Rekomandime specifike
- 1 Rekomandim unifikues


Rekomandimi unifikues për Dhomën Kombëtare të Noterisë, i dalë pas kryerjes së disa hetimeve administrative pranë disa zyrave noteriale mbi bazë ankese individuale, ka për qëllim të rregullojë praktika dhe veprime në këtë shërbim, për shkak të konstatimit të problematikave të mëposhtme:

- ✓ *nuk identifikohen qartë bazat e të dhënave shtetërore, në të cilat legjitimohet akses i noterëve dhe kategoritë e të dhënave personale që duhet të aksesojnë në secilën prej tyre;*
- ✓ *aksesi në të dhëna në portalin e-Albania, në tejkalim të parimit të mjaftueshmërisë së të dhënave;*
- ✓ *mosgarantimi i plotë i informimit të subjekteve të të dhënave për përpunimin e të dhënave në portalin e-Albania nga punonjësit e sektorit të shërbimit të noterisë;*
- ✓ *mospërcaktimi i qartë i të drejtave dhe detyrimeve të palëve të përfshira në marrëveshjen midis Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe AKSHI-t, duke marrë në konsideratë parashikimet/kufizimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale;*
- ✓ *mospërpilimi dhe mosaplikimi nga sektori i shërbimeve të noterisë të “deklaratës së pëlqimit” për përpunimin e të dhënave personale, ndaj individëve që u ofrohen këto shërbime;*
- ✓ *përmbushja për herë të parë e detyrimit për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit, si dhe mospërditësimi i tij;*

- ✓ mungesë e dokumentacionit rregullator për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, duke parashikuar masa konkrete për secilën hallkë të procesit.

2.2.2 Vendime

Për shkeljet e konstatuara Komisioneri ka dalë me 17 Vendime, të cilat korrespondojnë me 63 sanksione administrative.




Nga një vlerësim analitik i vendimmarrjes, shkeljet e konstatuara kanë një ndikim të lartë në privatësinë e qytetarëve dhe eventualisht, mund të përbëjnë dëm afatgjatë për ta. Është e rëndësishme të theksojmë se kultura e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit është vlerë e shtuar për veprimtarinë funksionale të kontrolluesit, si në sferën publike, ashtu edhe në atë private. Duke marrë në konsideratë përparimet teknologjike nga optika e ofrimit të shërbimeve digjitale, bëhet edhe më domethënëse që vëmendja të përqendrohet te marrja e masave të domosdoshme tekniko-organizative për garantimin e plotë të këtyre të drejtave.

2.3 REGJISTRI I NJOFTIMEVE

Gjatë vitit 2022, në përmbushje të detyrimit ligjor kanë njoftuar për përpunimin e të dhënave personale 57 subjekte kontrolluese. Gjithashtu, u regjistruan deklaratat e 35 kontrolluesve, për ndryshim të gjendjes së njoftimit të mëparshëm. Numri i subjekteve kontrolluese të regjistruara në Regjistrin e Subjekteve Kontrolluese në total është 5875.

—◆— REGJISTRI I NJOFTIMEVE



2.4 TRANSFERIMI NDËRKOMBËTAR

Është ndjekur me përparësi monitorimi i procesit të transferimit ndërkombëtar në funksion të mbrojtjes më të mirë të të dhënave personale të qytetarëve. Njëkohësisht, me indicie nga plotësimi i Formularit të Njoftimit, në rastet ku është konstatuar se realizohet transferim në vende me nivel jo të mjaftueshëm, është kërkuar informacion shtesë nga kontrolluesit dhe më tej janë shqyrtuar praktikatat përkatëse të transferimeve ndërkombëtare.

Zyra e Komisionerit trajtoi 5 praktika për autorizimin e transferimit në disa shtete me nivel jo të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, për të cilët pas vlerësimit ligjor të kryer është konkluduar se nuk kanë qënë në kushtet për t'u pajisur me autorizim për transferimin e të dhënave personale.

3. VEPRIMTARIA JURIDIKE, PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE

Finalizimi me sukses gjatë vitit 2022 i procesit të miratimit të 3 akteve ligjore, ka ndikim të drejtpërdrejtë në zgjerimin e rolit dhe funksioneve të Zyrës së Komisionerit, por nga ana tjetër, ato përbëjnë edhe përmbushje të detyrimeve në kuadër të integritetit evropian të vendit. Në këtë kontekst, plotësimi i kuadrit ligjor edhe me aktet e tjera do të konsiderohet si pikë kthese në konsolidimin institucional, pavarësinë e tij dhe forcimin e kapaciteteve profesionale.

3.2 MIRATIMI I AKTEVE LIGJORE

3.2.1 Ratifikimi i Konventës 108+ të KiE

Konventa e Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale” (Konventa 108), për më shumë se 40 vjet, shërben si bazë e legjislacionit ndërkombëtar në këtë fushë. Republika e Shqipërisë e ka bërë tashmë këtë instrument pjesë të kuadrit ligjor kombëtar, me ligjin nr. 9288/2004.

Me qëllim për t’iu përgjigjur sfidave të zhvillimit ekonomik e shoqëror, e sidomos atyre teknologjike, në përmbushje të rekomandimeve të adresuara ndër vite nga dokumente ndërkombëtare, u nënshkrua më 28 janar 2022, në Ditën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Protokollin ndryshues (CETS No. 223) i kësaj Konvente (njohur ndryshe si Konventa 108+).

Ky hap u pasua me përmbylljen e procesit të miratimit të ligjit nr. 49/2022, datë 12.05.2022, “Për ratifikimin e Protokollit ndryshues të Konventës “Për mbrojtjen e individëve, në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”. Në korrik të vitit 2022 u depozitua instrumenti i ratifikimit në KiE dhe nisja e zbatimit të këtij akti pritet pas plotësimit të numrit përkatës (38) të shteteve që e ratifikojnë atë. Konventa 108+ përmban standardet më të larta për garantimin e të drejtave të individit në këtë fushë dhe është hartuar në njëjtën frymë me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) të Bashkimit Evropian. Në cilësinë e iniciatorëve të procesit të ratifikimit, vlerësojmë maksimalisht angazhimin e të gjitha institucioneve shtetërore në përmbylljen e tij, duke e renditur Shqipërinë në grupin e vendeve me një kuadër rregullator bashkëkohor dhe që pritet të plotësohet me miratimin e projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të përafëruar me *acquis-në* e BE-së.

3.2.2 Ratifikimi i Konventës 205 të KiE

Akti i dytë i nënshkruar gjatë këtij viti nga Shqipëria është Konventa e KiE-së “Mbi aksesin në dokumente zyrtare” (njohur ndryshe si Konventa 205). Ky instrument garanton zbatimin e standardeve më të larta ndërkombëtare për aksesin e qytetarëve në informacionin/dokumentacionin që prodhojnë/ruajnë autoritetet publike. Konventa ka në thelb parimin e transparencës së tyre në funksion të mirëqeverisjes, për forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës.

Konventa 205 u nënshkrua po më 28.01.2022 dhe u pasua me procesin e miratimit të ligjit nr. 45/2022, datë 28.04.2022 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumenta zyrtare”. Depozitimi i instrumentit të ratifikimit u bë në korrik të po këtij viti, ndërsa prej 1 nëntorit 2022 Konventa ka hyrë në fuqi. Për shkak të specifikës të kësaj fushe, Zyra e Komisionerit është caktuar si përfaqësuese e vendit në Këshillin e Palëve të Konventës 205. Ky dokument u nënshkrua në Tromsø të Norvegjisë në qershor 2009 dhe përbën instrumentin e parë ligjor ndërkombëtar detyrues që kodifikon këtë të drejtë dhe liri themelore të individit në forcimin e besimit të tyre te autoritetet publike. E njëjta qasje bashkëpunuese u ndoq edhe në rastin e përmbylljes me sukses të procesit të përfshirjes së Konventës 205 në kuadrin rregullator kombëtar.

3.2.3 Miratimi i ligjit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik

Të dhënat e hapura mbështesin dhe inkurajojnë novacionin dhe rrisin përgjegjshmëri, duke përmirësuar demokracinë. Shumë vende zbatojnë programe transparence nëpërmjet publikimit të të dhënave “Open Data” në internet. Në këtë frymë, u miratua me VKM-në nr. 147/2015, dokumenti i politikës për të dhënat e hapura, si dhe është në funksion portali <http://opendata.gov.al/>, përdorimi i të cilit është në rritje.

Në vijim të këtij procesi u miratua ligji nr. 33/2022, datë 31.03.2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, i cili transpozon Direktivën e Bashkimit Evropian 2019/1024 me të njëjtën emërtesë. Ky ligj hyn në fuqi në prill të vitit 2023 dhe plotëson kuadrin rregullator të fushës së të drejtës për informim, nga këndvështrimi i përparimit teknologjik dhe digjitalizimit të shërbimeve.

Ky ligj ka për qëllim krijimin e bazës ligjore për promovimin e përdorimit të të dhënave të hapura në vendin tonë, duke nxitur më tej novacionin në ofrimin e produkteve dhe të shërbimeve publike me standarde të larta. Miratimi i këtij ligji mundëson gjithashtu ripërdorimin nga qytetarët dhe grupet e interesit të dokumenteve që mbahen nga organet e sektorit publik, ose sipërmarrjet publike. Me hyrjen në fuqi të këtij akti, Zyrës së Komisionerit i shtohet një tjetër kompetencë, duke u bërë institucioni përgjegjës për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtës për ripërdorim të dokumenteve, si dhe për procedurën e shqyrtimit të ankesave për moszbatimin e këtij ligji.

3.3 PROJEKTLIGJET PËR FUSHAT E PËRGJEGJËSISË

✓ Mbrojtja e të dhënave personale

Viti 2022 është karakterizuar nga një frymë intensive komunikimi dhe ndërveprimi me të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e hartimit të projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të përafëruar me GDPR-në dhe Direktivën e Policisë të BE-së. Në këtë kontekst, meqenëse jemi iniciatorë të kësaj nisme, kemi organizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, tryezat e konsultimit të projekt-aktit me përfaqësues nga sfera publike dhe ajo private. Nga ana tjetër, për shkak të rëndësisë që ka reforma në këtë fushë, ka qënë i domosdoshëm kontributi konkret i dhënë nga Komisioni Evropian dhe Delegacioni në Tiranë, në mënyrë që ligji i ardhshëm të jetë plotësisht i përafëruar me *acquis*-në e BE-së.

Puna e deritanishme është vlerësuar në takimin dypalësh BE-Shqipëri për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësimin në Bashkim Evropian, duke theksuar domosdoshmërinë për miratimin sa më të shpejtë të projekt-ligjit.


✓ E drejta për informim

Kemi ndjekur të njëjtën qasje ndërvepruese me Ministrinë e Drejtësisë edhe përsa i përket përmirësimeve të ligjit për të drejtën e informimit. Në kuadër të këtij procesi, kemi nxitur qytetarët dhe grupet e interesit të japin kontribut konkret për këtë nismë, në tyrezat dhe takimet e zhvilluara gjatë vitit 2022 për vlerësimin e ecurisë së zbatimit të kuadrit rregullator për këtë fushë.

Për shkak të ndërlidhjes që këto projekt-akte kanë me njëri-tjetrin, vlen të theksohet se miratimi i tyre do të duhet të bëhet në të njëjtën kohë.

3.4 DHËNIE MENDIMI PËR PROJEKT-AKTE

Për vitin 2022, Zyra e Komisionerit ka dhënë mendim për 27 projekt-akte rregullatore, ndër të cilat 6 projekt-ligje, 15 projekt-vendime dhe 6 projekt-marrëveshje.



Vlerësojmë se këto shifra janë tregues të ndërgjegjësimit në rritje të institucioneve për sa i takon zbatimin të detyrimit për të konsultuar projekt-aktet që kanë në objektin e tyre edhe përpunimin e të dhënave personale. Në këtë frymë, janë dhënë edhe 40 opinione për çështje/projekte të paraqitura nga kontrollues publik apo privat. Ndërsa, në Aneksin 3 të këtij Raporti gjendet lista me aktet rregullatore të miratuara gjatë vitit 2022, për të cilat Zyra e Komisionerit nuk është konsultuar paraprakisht, por krahasimisht me vitet e mëparshme ky numër konsiderohet i ulët.

3.5 PROCESE GJYQËSORE

Gjatë vitit 2022, Zyra e Komisionerit ka qenë palë në 47 procese gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për çështje me objekt zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit. Për procedurat e mbyllura, veçanërisht, përmendim faktin se gjykata konfirmoi vendimmarrjen e Zyrës së Komisionerit për 14 raste.

Çështje me objekt zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit”

	2022
Procese gjyqësore	47
Rrëzim padie	14
Pranim padie	3
Pushim gjykimi për Zyrën e Komisionerit	4
Pranim i pjesshëm i padisë	3
Çështje e kthyer për mangësi në kërkesë padi	1
Çështje të pezulluara	2
Çështje në proces	20

Institucioni ka qenë palë në 13 procese gjyqësore pranë Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për çështje me objekt legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, ku në 8 raste gjykata ka lënë në fuqi vendimmarrjen e Zyrës së Komisionerit.

Çështje me objekt zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale

	2022
Procese gjyqësore	13
Rrëzim padie	8
Pranim i pjesshëm i padisë	1
Çështje në proces	4

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit është palë në 54 procese gjyqësore që shqyrtohen në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Gjatë vitit 2022, u trajtua vetëm 1 çështje.

4. DOKUMENTE STRATEGJIKE

Në përmbushje të misionit dhe vizionit tonë, kemi përcaktuar objektiva konkretë e afatgjatë në dokumentet e Strategjisë Institucionale dhe Planit të Integritetit. Nga ana tjetër, duke marrë në konsideratë rolin dhe veprimtarinë tonë, jemi bërë pjesë e disa strategjive ndërsektoriale.

4.1 STRATEGJIA INSTITUCIONALE 2022-2025

Komisioneri miratoi Strategjinë Institucionale 2022-2025, dokument i cili parashikon vizionin, misionin, objektivat dhe masat konkrete që do të realizohen në këtë periudhë. Strategjia është hartuar duke marrë në konsideratë kuadrin ligjor ekzistues dhe ecurinë e procesit të modernizimit të tij, si dhe dokumentet kombëtare/ndërkombëtare që vlerësojnë veprimtarinë e institucionit. Strategjia është hartuar me asistencën e ekspertëve të Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me *acquis-in* e Bashkimit Evropian”.

Ky dokument shoqërohet nga Plani i Veprimit 2022-2025, i cili shërben si një instrument programimi dhe monitorimi të aktiviteteve, për përmbushjen e çdo objektivi të parashikuar në këtë Strategji. Përmbushja e tyre ka si qëllim rritjen e nivelit të ushtrimit në praktikë të të drejtave themelore të individit, nëpërmjet zbatimit të standardeve më të larta rregullatore në të dy fushat e përgjegjësisë së autoritetit.



Strategjia Institucionale 2022-2025 u hodh për konsultimit publik dhe aktiviteti ku morën pjesë koordinatorë për të drejtën e informimit, persona të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale, përfaqësues të shoqatave të biznesit, të organizatave të shoqërisë civile apo medias, shënjoji përmbylljen e këtij procesi. Strategjia e Zyrës së Komisionerit gjendet e publikuar në faqen zyrtare të internetit.

4.2 PLANI I INTEGRITETIT 2022-2025

Komisioneri miratoi Planin e Integritetit të institucionit për periudhën 2022-2025. Ky dokument u hartua në kuadër të Projektit “Forcimi i integritetit për përmirësimin e shërbimeve publike”, zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, me mbështetjen e Ambasadës së Suedisë në Tiranë. Integriteti i institucioneve publike përbën një nga parimet më të rëndësishme të qeverisjes së mirë dhe është një nga treguesit e mirëfunksionimit të

demokracisë. Zyra e Komisionerit bëhet autoriteti i parë në kategorinë e institucioneve të pavarura që ka në zbatim një Plan Integriteti. Ky dokument përveçse është në funksion të përmirësimit të veprimtarisë së institucionit, përbën një instrument shumë të rëndësishëm për të matur përgjegjshmërinë, transparencën dhe llogaridhënien ndaj qytetarëve.



Plani i Integritetit është i bazuar në tre shtylla kryesore: forcimin periodik të kapaciteteve profesionale dhe administrative; modernizimin e legjislacionit parësor dhe dytësor të fushave të përgjegjësisë, si dhe realizimin e procesit të digjitalizimit të plotë të arkivës së institucionit. Për përmbushjen e plotë të parashikimeve ky dokument shoqërohet me një plan veprimi me hapa, masa dhe afate konkrete. Plani i Integritetit gjendet i publikuar në faqen e internetit të institucionit.

4.3 STRATEGJI NDËRSEKTORIALE

- **Strategjia Ndërsektorale për Reformën në Administratën Publike 2015-2022 (SNRAP) dhe Plani i Aktiviteteve 2018-2022**

Zyra e Komisionerit, si institucioni përgjegjës për realizimin e **Objektivit 11** “*Rritja e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion*”, ka plotësuar tërësisht masat e parashikuara për përmbushjen e tij.

- **Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit 2020-2023 (SNKK)**

Zyra e Komisionerit, si institucioni përgjegjës, realizoi të 3 masat e parashikuara në Planin e Veprimit për realizimin e **Objektivit A.1** “*Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion*”. Ndërkohë, institucioni është angazhuar për hartimin e objektivit specifik “*Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike në të gjithë sektorët dhe nivelet*” në projektin e SNKK-së dhe Planin e Veprimit 2023-2030.

- **Kontrata e Suportit Buxhetor për Mirëqeverisjen 2020**

Zyra e Komisionerit është institucioni përgjegjës për zbatimin e **Indikatorit nr. 7** të Kontratës së Suportit Buxhetor për Mirëqeverisjen IPA 2020 “*Transparenca e aktivitetit shtetëror dhe aksesit në informacion për qytetarët*”. Sipas kontratës, objektiv për vitin 2022 ishte “*122 autoritete publike të kenë instaluar REKPDI*”, duke e përmbushur plotësisht atë. Në fund të vitit 2022 numri i autoriteteve publike që kanë funksional REKPDI-në është 195.

▪ **Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP) dhe Plan i Veprimit 2019–2023**

Zyra e Komisionerit, si institucioni përgjegjës, përmbushi 5 masat për realizimin e **Objektivit IV** “Ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë e njohjes së ligjit, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevojat specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës”, të përfshirë në këtë dokument.

▪ **Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve (AKDF) dhe Plan i Veprimit 2021-2026**

Në këtë dokument, Zyra e Komisionerit është institucioni përgjegjës për realizimin e 2 objektivave specifike: **Objektivi II.2** - “Funksionimi i një sistemi gjithëpërfshirës dhe të dobishëm për mbrojtjen e fëmijëve” dhe **Objektivi IV.1** - “Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale”. Për periudhën e parashikuar në Planin e Veprimit, institucioni ka përmbushur plotësisht masat përkatëse.

▪ **Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur (SNDM) dhe Plan i Veprimit 2022-2026**

Zyra e Komisionerit është institucioni përgjegjës për përmbushjen e **Objektivit** “Informim/edukim/ndërgjegjësim në qarqet e targetuara për parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre dhe qasja në drejtësinë miqësore në çdo kohë për çdo fëmijë”, nëpërmjet realizimit të masës *Fushatë kombëtare ndërgjegjësuere me fokus promovimin e mbrojtjes së të dhënave personale të fëmijës, veçanërisht të fëmijëve viktimë, të fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin, si dhe në sistemin arsimor të vendit (mësues, nxënës, student, staf akademik/administrativ)*. Sipas Planit të Veprimit të Strategjisë, afatet e zbatimit të tyre janë përcaktuar për periudhën 2023-2026.

▪ **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030 (SKZHI)**

Zyra e Komisionerit është përfshirë në hartimin e SKZHI 2022-2030 dhe Planin i Veprimit, duke propozuar objektiva konkretë për të dy fushat e përgjegjësisë. Ato kanë për qëllim rritjen e besimit të qytetarëve për ushtrimin e të drejtave kushtetuese nëpërmjet zbatimit të standardeve më të larta rregullatore në këto fusha.

5. VEPRIMTARIA E BASHKËPUNITIT NDËRKOMBËTAR

Shkëmbimi i ekspertizës dhe praktikave më të mira me autoritete homologe është në mënyrë të pandërprerë në vëmendjen tonë, në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale të stafit.

5.1 BASHKËPUNIMI ME AUTORITETIN HOMOLOG TË REPUBLIKËS KOSOVËS

Në muajin prill 2022 u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit mes Zyrës së Komisionerit dhe Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Republikës së Kosovës. Ky dokument me karakter teknik, synon konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dhe ndërveprimit dypalësh. Marrëveshja bazohet në tre komponentë kryesore: shkëmbimi i eksperiencës dhe praktikave më të mira; mbështetje për institucionin homolog në anëtarësimin në organizata të ndryshme; si dhe në njohjen e ndërsjellë si shtete me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale (*adequacy*) për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë dhe shkëmbimit midis dy vendeve.



Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes, gjatë muajit shtator 2022 u mbajt takimi i parë i përbashkët, qëllimi i të cilit ishte shkëmbimi konkret i përvojës profesionale dhe administrative mes stafeve të të dy autoriteteve. Në të u prezantuan detyrat dhe kompetencat e njësive përbërëse të Zyrës së Komisionerit dhe procesi i modernizimit të kuadrit ligjor në të dy fushat e përgjegjësisë. Po ashtu, u trajtuan raste konkrete dhe vendimmarrja në lidhje me to, ku u diskutua mbi të përbashkëtat dhe veçoritë që parashikon kuadri rregullator në shtetet përkatëse. Produkt konkret i Marrëveshjes ishte dhe kontributi që Zyra e Komisionerit ka dhënë për anëtarësimin e AIP-së në ICIC në dhjetor 2022.

5.2 BASHKËPUNIMI ME AUTORITETIN HOMOLOG TË MALTËS

Në muajin shtator 2022 u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit me Autoritetin homolog për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Maltës. Qëllimi i saj është forcimi dhe thellimi i njohurive/eksperiencës në drejtim të mbikëqyrjes së legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave personale, më vëmendje të veçantë tek modernizimi i kuadrit ligjor shqiptar në këtë fushë sipas standardeve të GDPR-së. Kjo marrëveshje parashikon, zgjerimin e bashkëpunimit në drejtim të qarkullimeve ndërkufitare të të dhënave personale, shkëmbimit të informacionit, praktikave e përvojave më të mira për përmirësimin e kapaciteteve administrative, organizimin e aktiviteteve/projekteve të përbashkëta për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit në këtë fushë. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i kësaj Marrëveshje

është edhe bashkëpunimi në funksion të Konventës 108 të KiE-së dhe asistencë reciproke për modernizimin e vazhdueshëm të legjislacionit.



5.3 BASHKËPUNIMI ME QEVERINË E MBRETËRISË SË BASHKUAR

Zyra e Komisionerit dhe ambasada e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe në Tiranë po bashkëpunojnë në vitin e dytë në kuadër të projektit “Përmirësimi i hapjes dhe llogaridhënies të qeverive të Ballkanit Perëndimor përmes zhvillimit të komunikimeve efektive strategjike - *Improving the openness and accountability of the governments of the Western Balkans through the development of effective strategic communications*”. Ky është një projekt 3-vjeçar dhe po zbatohet nga “Shërbimi Ndërkombëtar i Komunikimeve Qeveritare - *Government Communications Service International*”. Me mbështetjen e tij është hartuar, publikuar në faqen zyrtare të institucionit dhe është shpërndarë materiali mbi rolin e koordinatorit për të drejtën e informimit, i cili përmban informacione dhe udhëzime praktike mbi veprimtarinë e tij.



Pjesë e këtij projekti është edhe mbështetja në organizimin e nismës “Ditët e Transparencës” të zhvilluar me autoritete publike që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e një qarku, siç është përmendur në Kapitullin 1 të këtij Raporti.



5.4 PJESËMARRJA NË FORUME DHE RRJETE NDËRKOMBËTARE

5.4.1 Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit

Në datat 22-24 qershor, u zhvillua edicioni i 13-të i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit, organizuar nga Autoriteti Federal meksikan për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (INAI). Kjo konferencë përbën forumin qendror botëror për trajtimin e problematikave në lidhje me nxitjen e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies së autoriteteve publike. Tematika e Konferencës ishte “*Akresi në informacion, pjesëmarrja dhe përfshirja në epokën digjitale*”, ku punimet e tij u ndoqën në format hibrid (fizikisht/online) nga përfaqësues të autoriteteve anëtare, organizatave partnere, bota akademike, shoqëria civile, media, etj.



Punimet e Sesionit të Hapur u mbajtën në datat 22-23 qershor, në të cilin u trajtuan një sërë çështjesh dhe u zhvilluan diskutime për sfidat e informacionit publik dhe transparencës në raport me inteligjencën artificiale, *cloud* apo *blockchain*. Po ashtu, interes patën edhe temat në lidhje me aksesin në dokumentacionin publik, dezinformimin dhe lirinë e shtypit në epokën digjitale, si dhe transparenca proaktive, si mjet efikas në promovimin e rritjen e hapjes së institucioneve. Njëkohësisht në këtë Konferencë, u mbajtën një sërë aktiviteteve paralele dhe seminare nga UNESCO-ja, grupet ndërkombëtare të punës dhe rrjetet e ndryshme rajonale.

Sesioni i Mbyllur i ICIC-së i zhvilloi punimet në datë 24 qershor, ku u diskutua mbi veprimtarinë përgjatë 12 muajve të kaluara dhe u miratua Raporti Vjetor, si dhe u prezantuan raportet e grupeve të punës, apo grupet rajonale mbi zhvillimet në këtë fushë. Zyra e Komisionerit është anëtare në Grupin e Punës për “Transparencën që në fazën e konceptimit” (*Transparency by Design Working Group*) dhe Grupin e Punës për Trajnimet (*Training Working Group*) të ICIC-së.



Në cilësinë e anëtarit të Komitetit Ekzekutiv të ICIC-së, kemi marrë pjesë në mënyrë aktive në takimet e tij, duke dhënë kontribut konkret në vendimmarrje dhe në avancimin e proceseve të funksionimit të organizatës.

5.4.2 Asambleja Globale e Privatësisë

Në datat 25-28 tetor 2022, Asambleja Globale e Privatësisë zhvilloi edicionin e 44-t, me tematikë kryesore “Një çështje ekuilibri: privatësia në epokën e avancimit të shpejtë teknologjik”, organizuar nga Autoriteti turk i Mbrojtjes së të Dhënave Personale.



Në punimet e Sesionit të Mbyllur u miratuan këto dokumente në funksion të përmirësimit të standardeve rregullatore të fushës:

- Rezoluta mbi parimet dhe pritshmëritë për përdorimin e përshtatshëm të informacionit personal në teknologjinë e njohjes së fytyrës;
- Rezoluta për ngritjen e kapaciteteve të bashkëpunimit ndërkombëtar për përmirësimin e rregullores së sigurisë kibernetike dhe kuptimin e dëmeve nga incidenti kibernetik;
- Rezoluta për ndryshimin e udhërrëfyesit dhe afatit kohor për financimin e Sekretariatit të GPA.

Në punimet e Sesionit të Mbyllur përfaqësues nga 163 autoritete anëtare dhe vëzhguese shprehën vullnetin për të promovuar bashkëpunimin ndërkombëtar në zbatimin e harmonizuar të legjislacionit, zgjerimin e kapaciteteve për realizimin e hetimeve proaktive të përbashkëta dhe shkëmbimin e vazhdueshëm të praktikave më të mira. Në Sesionin e Mbyllur u paraqitën e miratuan raportet vjetore të Grupeve të Punës të GPA-së dhe u prezantua veprimtaria e disa organizmave partnere.

Punimet e Sesionit të Hapur ishin të ndara në 8 panele të ndryshme dhe u fokusuan në sfidat e inteligjencës artificiale në raport me legjislacionin, etikën dhe demokracinë, apo problematikat

në lidhje me përdorimin e teknologjisë së njohjes së fytyrës. Vëmendje iu kushtua çështjes së ndërveprimit të të drejtave të konsumatorit, konkurrencës dhe privatësisë, rolin e sektorit privat në përdorimin e teknologjive të mbikëqyrjes, si dhe trajtimin e të dhënave masive (*big data*) nga këndvështrimi i privatësisë. Me interes u ndoqën edhe diskutimi rreth temave që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen masive në rrjet, *blockchain-in* dhe *metaverse-in*, marrëdhënia e besimit mes digjitalizimit dhe privatësisë, kuadri rregullator për të dhënat ndërkufitare, rreziqet për grupet e cënueshme, mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijëve në epokën digjitale, si dhe bashkëpunimin për menaxhimin e fatkeqësive/krizave dhe ndihmën humanitare.

5.4.3 Pjesëmarrja në forume të tjera

Në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare, kemi marrë pjesë në takime, trajnime e seminare të organizuara nga:

- Komiteti Konsultativ i Konventës 108 të Këshillit të Evropës (T-PD);
- Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave (EDPB);
- Konferenca Evropiane e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (ECDPA);
- Seminari i Shqyrtimit të Rasteve Praktike (Case Handling Workshop) të Konferencës Evropiane;
- Grupi Ndërkombëtar i Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Teknologji (Grupi i Berlinit).

6. NDËRGJEGJËSIMI DHE BASHKËPUNIMI ME GRUPET E INTERESIT

Veprimtaria në kuadër të ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit me grupet e interesit është një nga komponentet kryesore të punës sonë. Ky ndërveprim ka konsistuar në zhvillimin e një sërë aktiviteteve e nismash trajnuese me fokus brezin e ri, ndërsa bashkëpunimi me aktorë të shoqërisë civile ka vijuar në realizimin e projekteve dhe iniciativave konkrete.

6.1 DITËT NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE

▪ 28 Janar, Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale

Në kuadër të 28 Janarit, Zyra e Komisionerit shpërndau një pyetësor për evidentimin e njohurive të nëpunësve të kontrolluesve publik për mbrojtjen e të dhënave personale dhe respektimin e kësaj të drejte themelore. Pyetësi iu drejtua konkretisht atyre kontrolluesve publikë të cilët përpunojnë sasi të konsiderueshme dhe në mënyrë të vazhdueshme të dhëna personale të qytetarëve shqiptarë e të huaj. Rezultatet e Pyetësit u prezantuan në një aktivitet të posaçëm, me pjesëmarrjen e mbi 100 përfaqësuesve dhe nëpunës të mbrojtjes së të dhënave personale nga institucione qendrore, të pavarura dhe të vetëqeverisjes vendore. Në vlerësim të rezultateve, Zyra e Komisionerit konstaton se niveli i njohjes së legjislacionit të fushës është i pamjaftueshëm dhe sidomos kërkohet vëmendje e shtuar për rritjen profesionale nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme. Rezultatet e pyetësit gjenden të publikuara në faqen zyrtare.

▪ 28 Shtator, Dita e të Drejtës për Informim

Me rastin e 28 Shtatorit, zhvilluam një aktivitet me një grup prej mbi 30 nxënësish dhe mësuesish të gjimnazëve të Tiranës “Ismail Qemali”, “Sami Frashëri”, Petro Nini Luarasi”, “Qemal Stafa” dhe “Partizani”. Ky takim kishte për qëllim njohjen e fushës së qasjes në informacionin publik që prodhojnë/administrojnë institucionet dhe kultivimin e kulturës së ndërgjegjësimit të ushtrimit të të drejtës së informimit. Të rinjtë u njohën me funksionet dhe veprimtarinë e institucionit, mënyrat dhe mjetet për ushtrimin praktik të saj, duke patur sa më shumë akses në informacionin publik. Në fokus ishte trajtimi i çështjeve apo problematikave të konstatuara në sektorin e arsimit, puna për forcimin e transparencës proaktive nëpërmjet përditësimit periodik të Programit të Transparencës, si dhe njohuri për rolin e koordinatorit për të drejtën e informimit.

6.2 AKTIVITETE ME ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE

Vijojmë t’i kushtojmë rëndësi të veçantë ndërveprimit me organizatat e shoqërisë civile (OSHC) dhe median, si partnerë në funksion të interesit publik, për kultivimin e kulturës së ndërgjegjësimit të qytetarëve për ushtrimin e të drejtës për informim dhe pjesëmarrjes në qeverisje. Gjatë këtij viti, bashkëpunimi me grupet e interesit konsistoi në zhvillimin dhe pjesëmarrjen aktive në projekte e iniciativa, si:

- institucioni organizoi një takim me OSHC-të për prezantimin e sistemit AMS në portalin e-Albania;
- tryezë diskutimi organizuar nga LëvizAlbania me temë “*Gazetaria vendore në kohë krizash*”, ku prezantuam ndryshimet e ligjit “Për të drejtën e informimit”, duke mirëpritur sugjerimet dhe propozime konkrete për përmirësimin e tij;
- takim i organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit me temë “*Barometri i parë kombëtar për të drejtat e njeriut dhe kufizimet gjatë periudhës së pandemisë*”;


- konferenca e organizuar nga organizata *Faktoje* me temë “*Dita ndërkombëtare e verifikimit të fakteve në Shqipëri*”;
- takime të organizuara nga Lëvizja Mjaft me tematika “*Prezantimi i hapjes institucionale të pushtetit ekzekutiv*”, “*Prezantimi i hapjes institucionale të pushtetit gjyqësor*” dhe “*Prezantimi i hapjes institucionale të njësive të vetëqeverisjes vendore*”;
- aktiviteti me temë “*Praktika të demokracisë digjitale në nivel vendor*” organizuar nga LëvizAlbania;
- aktiviteti i organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim për edukimin e trajnerëve për zbatimin e Planeve të Integritetit në Administratën Publike;
- konferenca e 3-të Rajonale organizuar nga autoriteti homolog i Maqedonisë së Veriut, në kuadër të “*Iniciativës 2020*”, me tematikë “*Transparenca proaktive dhe Konventa e Tromsos (Konventa 205 e KiE)*”. Zyra e Komisionerit prezantoi eksperiencën shqiptare në promovimin e të drejtës për informim dhe në veçanti, të transparencës proaktive të autoriteteve publike;
- aktiviteti i organizuar nga ICIC-ja dhe UNESCO-ja për “*Promovimin e barazisë gjinore në kuadër të së drejtës për informim*”;
- aktiviteti online i organizuar nga UNESCO-ja dhe organizata Access Info Europe me temë “*Inteligjenca Artificiale, Qeverisje elektronike dhe akses në informacion*”;
- aktiviteti i organizuar nga USAID-i dhe organizata Balkan Trust for Democracy me temë “*Reagimi dhe përshtatja e organizatave të shoqërisë civile ndaj situatës COVID-19*”.

6.3 AKTIVITETE TË TJERA TË ZYRËS SË KOMISIONERIT

- Kemi zhvilluar aktivitetin me rastin e krijimit të “*Rrjetit të nëpunësve për mbrojtjen e të dhënave personale*” si platforma e komunikimit, bashkëpunimit dhe e ndarjes së praktikave të mira në funksion të garantimit të të drejtave të qytetarëve. Në këtë takim morën pjesë mbi 110 përfaqësues nga kontrollues publikë e privatë që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fusha e sektorë të ndryshëm, si telekomunikacioni, shërbimet bankare e financiare, sigurimeve, shëndetësisë, arsimit, turizmit, etj. Ndërmarrja e kësaj nisme është përmbushje e rekomandimit të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë 2022. Për këtë qëllim, kemi krijuar edhe Regjistrin përkatës, i cili është në proces përditësimi të vazhdueshëm me të dhëna të raportuara nga vetë kontrolluesit edhe si rezultat i plotësimit të Formularit të Njoftimit.
- Në bashkëpunim me Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore, zhvilluam trajnimin 4-ditor, me pjesëmarrjen e më shumë se 60 nëpunësve të nivele/strukturave të ndryshme qendrore e vendore të këtyre institucioneve. Në fokus të këtij aktiviteti ishte njohja e zgjeruar e legjislacionit në fuqi për të dy fushat e përgjegjësisë së autoritetit, roli e funksionet e tij, si dhe zbatimi i kuadrit rregullator në raport me veprimtarinë e administratës tatimore dhe asaj doganore. Vëmendje iu kushtua, nëpërmjet shqyrtimit të rasteve specifike të trajtuara nga autoriteti ndër vite, forcimit të transparencës proaktive të këtyre institucioneve, trajtimit të dy të drejtave në balancë me njëra-tjetrën, si dhe masave tekniko-organizative për nivel të lartë sigurie në përpunimin e të dhënave personale.

- Në bashkëpunim me Shoqatën Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA) zhvilluam seminarin “*E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale në fushën e biznesit*”. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin përfaqësues nga subjekte/shoqëri anëtare të kësaj organizate, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fusha e sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Të pranishmit u njohën me rolin, funksionet dhe kompetencat e Zyrës së Komisionerit, si dhe drejtimit kryesore të veprimtarisë mbikëqyrëse.
- Nënshkruam Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë dhe Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë, me qëllim ndërgjegjësimin për ushtrimin në praktikë të të drejtave, aksesit në informacionin publik dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Marrëveshja do të ndikojë në bashkëpunimin dhe ndërveprimin për çështje që prekin objektin e veprimtarisë së tre palëve, duke u angazhuar, ndër të tjera në trajtimin e rasteve të individëve që u përkasin këtyre komuniteteve në raport me veprimtarinë e organeve të administratës publike, apo entiteteve private, në optikën e fushave të përgjegjësisë së Zyrës së Komisionerit, apo propozimin e iniciativave për ndryshime rregullatore në rritjen e cilësisë së shërbimeve për këto komunitete.
- Zhvilluam 2 takime me përfaqësues të autoriteteve publike, bazuar në rezultatet e indeksit të transparencës 2021 me qëllim zbatimin e praktikave më të mira mbi përditësimin e informacionit në Programin e Transparencës.
- Zhvilluam 3 trajnime për përdorimin e REKPDI-së me pjesëmarrjen e koordinatorëve dhe stafeve të TIK-ut nga 100 autoritete publike qendrore/të varësisë, të pavarura, sistemit të drejtësisë (gjykata/prokurori) dhe njësi të vetëqeverisjes vendore.
- Në bashkëpunim me AKSHI-in zhvilluam 4 trajnime me koordinatorë të autoriteteve publike ku është instaluar sistemi AMS, për njohjen e detajeve teknike të përdorimit të tij.
- Në kuadër Ditës së Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Universitetit European të Tiranës organizoi forumin me temë “*A i mbrojmë të dhënat personale?*”. Në këtë aktivitet, me pjesëmarrjen e Komisionerit, u trajtuan çështje të aktualitetit të kësaj fushe, ku u dhanë këshilla praktike në lidhje me sjelljen e qytetarëve për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Universitetit Mesdhetar organizoi leksionin e hapur me temë: “*Forcimi i kulturës së ushtrimit të të drejtave të qytetarëve*”. Si i ftuar në këtë leksion të hapur, Komisioneri diskutoi me studentë dhe stafin akademik çështje të mbrojtjes së të dhënave personale dhe fushës të së drejtës për informim.
- Organizuam bashkërisht 3 aktiviteteve me studentë të Fakultetit të Drejtësisë dhe atij Ekonomik të Universitetit të Tiranës, të Universitetit Mesdhetar dhe me anëtarë të shoqatës Roma Versitas Albania. Tematika e trajnimeve preku kuadrin rregullator dhe veprimtarinë mbikëqyrëse të institucionit.
- Forcimi i bashkëpunimit mes autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave personale të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi, ishte qëllimi i organizimit të

takimit të mbajtur në Prishtinë organizuar nga AIP-ja. Zyra e Komisionerit dha kontribut në diskutimet për shkëmbimin e përvojave më të mira në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe trajtimin e rasteve konkrete në sektorët e sigurisë, shëndetësisë, arsimit apo dhe telekomunikacionit. Në takim, u vlerësuan mundësitë për thellimin e bashkëveprimit rajonal dhe adresimin e problematikave të përbashkëta për respektimin e kësaj të drejte të individit.



- U publikua Revista “Informim Dhe Privatësi”, numrat 13 dhe 14, përmbledhje të veprimtarisë institucionale, respektivisht, për 6-mujorin I dhe II të vitit 2022.
- U publikuan 12 Newsletters “E drejta për informim”, përmbledhje njohëse mujore mbi veprimtarinë, mbikëqyrjen për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit.

7. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCIARE

7.1 STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Veprimtaria e institucionit ushtrohet në përputhje me strukturën dhe organikën, prej 44 punonjësish, e miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 84/2020 *“Për disa shtesa e ndryshime të Vendimit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*”.

Kuadri i modernizuar ligjor për të dy fushat e përgjegjësisë shton kompetencat dhe funksionet mbikëqyrëse, çka sjell si domosdoshmëri shtimin e kapaciteteve administrative për përmbushjen e tyre, si në terma sasiorë ashtu edhe cilësorë. Në këtë kontekst, iu propozua institucioneve përkatëse një strukturë e plotë dhe efikase më një numër shtesë prej 16 punonjësish, për një total prej 60 personash. Ky proces rezultoi me pranimin e pjesshëm të kërkesës, ku me Aktin Normativ nr. 12/2022 dhe Ligjin e Buxhetit të vitit 2023, u miratua shtesa prej 8 nëpunësish, e cila do të reflektohet me vendimmarrjen përkatëse të Kuvendit gjatë vitit 2023. Megjithatë, vlerësojmë se organika prej 52 punonjësish mbetet ende e pamjaftueshme për ushtrimin në mënyrë efikase dhe gjithëpërfshirëse të kompetencave të parashikuara si në ligjet organike ashtu edhe në ato të përcaktuara në akte të tjera.

Ky shqetësim është theksuar në mënyrë konstante në Progres-Raportet e Komisionit Evropian ndër vite, vijuar edhe në dokumentin për 2022, ku citohet:

“Burime shtesë njerëzore dhe financiare do të duhet t'i alokohen Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e Informacionit dhe të Dhënave për kryerjen efektive të detyrave të tij dhe ushtrimin e kompetencave të tij, për të përmbushur rolin e tij të zgjeruar.”

Gjatë vitit 2022, u zhvilluan 17 procedura rekrutimi, ku në këtë numër përfshihen edhe ato të rishpallura, për pozicionet vakante në organikë, një pjesë e tyre ende janë të paplotësuar. Zyra e Komisionerit thekson se pamundësia e plotësimit të tyre vjen si rezultat i mungesës së ekspertizës së duhur nga kandidatët. Një faktor tjetër që ka ndikuar në këtë problematikë, është ofrimi i pagave më të larta në sektorin privat për këto lloj pozicionesh që kërkojnë këtë nivel të lartë profesional (veçanërisht, fusha e mbrojtjes së të dhënave).

Vlerësojmë se mekanizmi për t'i dhënë një zgjidhje afatgjatë këtyre shqetësimeve për të gjitha institucionet e kësaj kategorie do të ishte rishikimi i ligjit nr. 9584/2006 *“Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”*. Në këtë frymë modernizuese, duhet parashikuar që struktura dhe organika e institucioneve të pavarura të krijuara me ligj, njësoj si ato kushtetuese, të jetë kompetencë e vetë institucionit. Kjo do të sjellë pavarësi, efektivitet dhe fleksibilitet në organizimin e punës dhe veprimtarisë funksionale.

Ndërkohë, në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve profesionale të stafit janë ndjekur trajnimet periodike në bashkëpunim me ASPA dhe me partnerë të huaj, sipas fushave të përgjegjësisë. Nga ana tjetër, miratimi i Planit të Integritetit 2022-2025 do të nxisë kulturën dhe etikën në këtë rrafsh në të gjitha nivelet e stafit.

7.2 MENAXHIMI I BUXHETIT

Në zbatim të ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” fondet e akorduara për Zyrën e Komisionerit, në total u miratuan në vlerën 78.340 (mijë lekë). Me ndryshimet gjatë vitit buxheti përfundimtar shkoi në vlerën **79.252** (mijë lekë). Realizimi faktik i buxhetit është në vlerën **78.282** (mijë lekë) ose në nivelin **98.7%**.

BUXHETI DHE REALIZIMI

000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plan vjetor 2022 (i ndryshuar)	Struktura në % kundrejt totalit	Fakti vjetor	% realizimi kundrejt planit vjetor për kategori
1	Paga	47.402	60%	47.017	99%
2	Sigurime shoqërore	8.092	10.3%	7.785	96%
3	Mallra e shërbime të tjera	18.128	23%	18.084	99.7%
4	Investime	4.500	5.7%	4.412	98%
5	Transferta te buxhetet familjare	240	0.3%	240	100%
6	Kuotizacione	100	0.01%	74	74%
7	Fondi i veçantë	790	0.3%	670	85%
	Totali	79.252		78.282	98.7%

Ndër treguesit kryesorë të shpenzimeve, pjesën qendrore e përbëjnë pagat, realizuar në vlerën 47.017 (mijë lekë) ose 99% dhe kontributet për sigurimet shoqërore/shëndetësore, realizuar në shifrën 7.785 (në mijë lekë) ose 96%. Shpenzimet korrente dhe investimet u realizuan në vlerën 22.810 (mijë lekë) ose 99%. Për Zyrën e Komisionerit është akorduar Fondi i Veçantë me vlerë 790 (mijë lekë), i cili referuar akteve administrative është përdorur për mbështetje të punonjësve, në masën 670 (mijë lekë) ose rreth 85%.

Në funksion të zhvillimit normal të veprimtarisë institucionale, një pjesë e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe sigurimi i infrastrukturës së nevojshme, janë financuar nga donacionet.

7.3 ARKËTIME NGA SANKSIONET

Për vitin 2022 sanksionet administrative e vendosura janë në shumën 12.020.000 lekë. Ekzekutimi i sanksioneve arkëtohet 100% në buxhetin e shtetit, duke u shlyer vullnetarisht ose nëpërmjet shërbimit përmbarimor.

Totali i sanksioneve në vitin 2022	12.020.000
Për shkelje të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale	11.570.000
Për shkelje të dispozitave të legjislacionit për të drejtën e informimit	450.000

Shuma totale e arkëtimit të sanksioneve administrative është 710.000, e cila ndahet në 150.000 për sanksionet e vendosur në vitin 2022 dhe vlera 560.000 për sanksione të vendosura në vitin 2021.

8. PROCESI I INTEGRIMIT EVROPIAN

Zyra e Komisionerit është pjesë e Kapitullit “Kriteri politik”, Reforma në Administratën Publike, Kapitullit 10 “Shoqëria e informacionit dhe media”, Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” dhe Kapitullit 24 “Drejtësia, liria dhe siguria” të procesit të integrimit evropian. Në kuadër të hapjes së negociatave për anëtarësim, institucioni ka qënë pjesë e grupeve negociatore për kapitujt e mësipërm duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në shkëmbimin e qëndrimeve të përgjithshme negociuese mes Shqipërisë dhe BE. Me nisjen e procesit të vlerësimit analitik të përafrimit të legjislacionit me *acquis-në* (procesi *screening*) institucioni ka patur një rol aktiv në takimet shpjeguese të Komisionit Evropian mbi legjislacionin e Unionit, si dhe në takimet dypalëshe për prezantimin e nivelit të përafrimit të *acquis-së* në legjislacionin kombëtar shqiptar.

Angazhimi konkret i institucionit për nivelin e zbatimit të kuadrit rregullator në fuqi dhe përafrimit të tij për këto dy të drejta në vendin tonë u prezantuan në drejtimet/çështjet e mëposhtme:

- *Acquis e BE-së;*
- *kuadri strategjik;*
- *legjislacioni kombëtar;*
- *kompetencat që rrjedhin nga ligjet e tjera të brendshme;*
- *kapacitetet administrative;*
- *aktivitetet e institucionit për vitet 2017-2021;*
- *bashkëpunimi me institucione të tjera kombëtare;*
- *ndërgjegjësimi;*
- *marrëdhëniet ndërkombëtare;*
- *buxheti;*
- *asistenca e huaj teknike;*
- *prioritetet për të ardhmen.*

Si pjesë e detyrimeve që burojnë nga këto angazhime, por jo vetëm, është dhënë kontribut edhe në:

- kuadër të Misionit të Vlerësimit të BE (*Peer Mission Review*) Zyra e Komisionerit ishte një nga institucionet shqiptare të përzgjedhura për auditim, proces për të cilin pritet raporti përfundimtar;
- përgatitjen e informacionit në kuadër të hartimit të Raportit të Shtetit për vitin 2022 të Komisionit Evropian dhe raportimin mbi zbatimin e rekomandimeve të vitit 2021;
- programimin e objektivave/masave institucionale në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025;
- pjesëmarrjen në 4 Grupe Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për kapitujt e sipërpërmendur;
- përgatitjen e informacionit mbi zbatimin e indikatorit përkatës të Zyrës së Komisionerit në Kontratën e Suportit Buxhetor për Mirëqeverisjen 2020.

Në Raportin e BE-së 2021 u adresua 1 rekomandim që përfshin fushën e përgjegjësisë së Zyrës së Komisionerit: *“Përmirësimi i sigurisë dhe akses i kufizuar në përdorimin e të dhënave personale në bazat e të dhënave nën kontrollin e shtetit”*, i cili u përmbush për aq sa është në kompetencë të institucionit, nëpërmjet realizimit të masave të mëposhtme:

- Rol aktiv në finalizimin e procedurave të miratimit të projektligjit *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i përafruar me GDPR dhe Direktivën e Policisë;
- Kryerja e hetimeve sektoriale *ex-officio* për kontrolluesit publikë mbi zbatimin e detyrimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Monitorim i zbatimit të rekomandimeve të lëna më herët nga Zyra e Komisionerit.

9. NIVELI I ZBATIMIT TË REZOLUTËS SË KUVENDIT

Për vitin 2022, Kuvendi, nëpërmjet Rezolutës, kërkoi nga Zyra e Komisionerit përmbushjen e rekomandimeve të mëposhtme:

- Të përmbyllë hetimin administrativ, mbi publikimin e databazës me të dhënat e pagave të qytetarëve të punësuar në sektorin publik dhe privat si dhe databazës me të dhënat e targave të automjeteve, brenda vitit 2022 (Nënkapitulli 2.1.3, faqe 20).
- Të luajë rol aktiv në përmbylljen e procedurave për modernizimin e kuadrit ligjor (Kapitulli 3, fq. 27).
- Të vijojë monitorimin dhe mbikëqyrjen proaktive të autoriteteve publike për verifikimin e përditësimit të Programit të Transparencës dhe të Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në veprimtarinë e tyre (Nënkapitulli 1.1 dhe 1.2, faqe 10-12).
- Të mbështesë autoritetet publike në qartësimin e çështjeve mbi interesin publik dhe rastet e kufizimit të dhënies së informacionit, si dhe të nxisë forcimin e rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit (Nënkapitulli 6.3, faqe 40).
- Të vijojë shtrirjen e instalimit të sistemeve elektronike AMS dhe REKPDII në sa më shumë autoritete publike (Nënkapitulli 1.4.1, faqe 16-17).
- Të monitorojë dhe mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me fokus masat tekniko-organizative për përpunimin e sigurt të tyre, veçanërisht Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI), duke u shtrirë edhe në sektorë të tjerë si ai i sigurimeve, financiar, jo-bankar, marketing i drejtpërdrejtë (Nënkapitulli 2.1.3, faqe 20-22).
- Të angazhohet në monitorimin e vazhdueshëm për zbatimin e masave të lëna në rekomandimet e mëparshme për kontrollues publik e privat (Nënkapitulli 2.1.3, faqe 23).
- Të angazhohet në krijimin e rrjetit të nëpunësve për mbrojtjen e të dhënave personale, diktuar nga përmirësimi i legjislacionit kombëtar të kësaj fushe (Nënkapitulli 6.3, faqe 40).
- Të sigurojë pjesëmarrje aktive në cilësinë e anëtarit të Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) dhe vijimin e angazhimit aktiv në organizmat e tjerë ndërkombëtare ku Zyra e Komisionerit është pjesë (Nënkapitulli 5.4.1, faqe 36-37).
- Të angazhohet në bashkëpunimin me qytetarë dhe grupe interesi për njohjen e kuadrit të modernizuar ligjor në të dyja fushat e përgjegjësisë dhe nxitjen e ndërgjegjësimit për zbatimin e tij (Kapitulli 6, faqe 39-42).

Zyra e Komisionerit i ka realizuar plotësisht këto 10 rekomandime, progresi i përmbushjes së tyre reflektohet në këtë Raport dhe Aneksat e tij.

10. VIZIONI

Dokumenti i Strategjisë Institucionale 2022-2025 përcakton objektivat madhorë të Zyrës së Komisionerit për periudhën afat-mesme. Realizimi i tyre është i mundur nëpërmjet harmonizimit të përpjekjeve dhe veprimtarisë me autoritetet publike dhe me kontrolluesit publik/privat për forcimin e mjedisit në garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve. Duke qënë se procesi i modernizimit të kuadrit rregullator për të dy fushat e përgjegjësisë është drejt finalizimit, fokusi i institucionit për vitin 2023, siç është përcaktuar edhe në Programin Vjetor të Punës, do të jetë njohja e risive nga të gjithë palët/aktorët që janë subjekt i zbatimit të tij. Në terma konkretë, këto objektiva janë reflektuar si më poshtë:

- ✓ miratimin e projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe ndryshimeve të ligjit “Për të drejtën e informimit”;
- ✓ miratimin e akteve nënligjore në zbatim të legjislacionit të ri;
- ✓ shtimin e burimeve njerëzore dhe financiare për forcimin e kapaciteteve administrative në kuadër të harmonizimit integral të legjislacionit në të dy fushat e përgjegjësisë;
- ✓ përmirësimin e kapaciteteve profesionale të stafit, me fokus të veçantë, thellimin e njohurive në funksion të përparimeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), si detyrime specifike që burojnë nga legjislacioni i përmirësuar;
- ✓ bashkëpunimin me qytetarët dhe grupet e interesit në njohjen e risive rregullatore në të dy fushat, në ndërgjegjësimin për zbatimin e tyre;
- ✓ komunikimin proaktiv me autoritetet publike për konsolidimin e kulturës së transparencës;
- ✓ trajnimin periodik të koordinatorëve për të drejtën e informimit, veçanërisht, për trajtimin e çështjeve me interes publik në balancë me kufizimet për dhënien e informacionit;
- ✓ nxitjen e qasjes së re të kontrolluesve/përpunuesve përsa i përket garantimit efektiv të sigurisë së informacionit (SMSI) në proceset përpunuese;
- ✓ përgjegjshmërinë e lartë të kontrolluesve publik për t’iu drejtuar Zyrës së Komisionerit për dhënien e mendimeve mbi projektaktet ligjore/nënligjore, që në objekt të tyre kanë përpunimin e të dhënave personale;
- ✓ zgjerimin e rrjetit të nëpunësve për mbrojtjen e të dhënave personale dhe forcimi i kapaciteteve profesionale për përmbushjen e detyrimeve ligjore;
- ✓ programimin e masave në kuadër të zhvillimit të edicionit të 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit në Tiranë më 2024;
- ✓ rolin aktiv në kuadër të organizmave ndërkombëtare ku Zyra e Komisionerit është anëtare, si dhe me autoritetet homologe në të dy fushat e përgjegjësisë;
- ✓ aplikimin për përfitimin e projekteve nga programe të asistencës nga fondet IPA të BE dhe/ose donatorë të tjerë, në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale dhe për ndërgjegjësimin e grupeve të interesit.